

LEXMARK  
LEGAL

KENI NEVOJË PËR KËSHILLA TË EKSPERTËVE PËR  
IMIGRACIONIN NË MB? MOS KËRKONI MË TEJ!

EKIPI YNË I AVOKATËVE ME PËRVOJË TË IMIGRACIONIT ËSHTË I  
SPECIALIZUAR NË:

- APLIKIMET PËR VIZË
- VENDBANIM TË PËRHERSHËM
- SHTETËSIA
- RASTET E AZILIT
- APELET PËR DËBIM

NE JEMI KËTU PËR T'JU UDHËHEQUR NË ÇDO HAP  
TË RRUGËS. SUKSESI JUAJ NË EMIGRACION  
ËSHTË MISIONI YNË!

KONTAKTONI LEXMARK LEGAL SOT PËR NJË TË ARDHME MË TË  
NDRITSHME NË MB. PARTNERI JUAJ I BESUAR I IMIGRACIONIT!

ANA: 07435119343 Office: 0208 090 2488  
ALDO: 07494181220  
SANTJOLA: 07742877853

The Winning Box, Aquis House,  
27-37 Station Road, Hayes, UB3  
4DX



*The Albanian*

VITI I 20 I BOTIMIT 25 SHTATOR 2023

Tel: 020 7018 7929 30 Avenons Road London E13 8HT

**SHTRENJTOHEN VIZAT DHE LEJE-QËNDRIMET!  
QEVERIA BRITANIKE UA  
FATURON KOSTOT TË HUAJVE**



PETRIT KUÇANA

**VOTA, SI FUNDI  
I SHPËRFILLJES  
SË DIASPORËS**



ARBEN MANAJ

Ministria e Brendshme britanike ose Home Office ka rritur tarifat për marrjen e vizave dhe çdo lloj leje qëndrimi, deri tek ato të qëndrimit të përhershme dhe ato për aplikimin për pasaporatat britanike, ndryshime që pritet të aplikohen nga data 4 tetor (vijon faqe 4)

**KUR DOSJET  
PËRDOREN  
SI ARMË**

DAUT DAUTI



**KOSOVA NUK  
ËSHTË KRIMEA**

SANDER LLESHAJ



**NJË DREKË NË JERUSALEM,  
NJË DREKË NË PARIS,  
20 VJET NDËRMJET**

VETON SURROI




**TIRANA ZYRTARE,  
KJO E PABINDUR  
KRONIKE**

SONILA MEÇO



**NË UASHINGTON MCGONIGAL  
E PRANOI FAJIN,  
NË TIRANË FAJI MBETI KOPIJ**

ANDI BUSHATI



**Akoma nuk keni një website?**

**Akoma nuk jeni regjistruar në Google**

Për çdo konsultim mund te vini në çdo kohë në zyrat tona

Adresa e zyrave: 30 Avenons Road, London, E13 8HT  
Tel:020 7018 7929 Mob: 073 4066 5946 Mob:078 5997 7545




The Albanian newspaper in London

**THE ALBANIAN**  
www.thealbanian.co.uk

www.thealbanian.co.uk

albania7@gmail.com

Tel: 020 7018 7929



### PETRIT KUÇANA

A do të përkrahni të drejtën e votës së emigrantëve shqiptarë nëpër vendet ku jetojnë?

Kjo ishte pyetja për ish-liderin e opozitës (tashmë kryeministër) Edi Rama në një nga holltet e London School of Economics këtu në Londër, diku shtatë vite më parë. Përgjigja e tij ishte një "Jo" e prerë, e ndjekur nga një fjali-justifikim se nëpër ambasada ishin njerëzit e Berishës dhe nuk

## VOTA, SI FUNDI I SHPËRFILLJES SË DIASPORËS

mund të garantohej vota.

Është kjo JO që të vjen ndërmend ndërsa në Shqipëri po përlind rikthimi i debatit për sistemin zgjedhor, që mesa duket, po rrëshqet drejt një ambalazhimi kozmetik, derisa fjala diasporë vazhdon të jetë në mungesë. Edhe optimisti më i madh shpejt përpara ndonjë konkludimi të qartë, nëse diçka do të mund të ndryshojë në qasjen ndaj diasporës tashmë të shtuar shumëfish. E diaspora mbetet spektatore e paepur e gjithçkaje që ndodh aty, e tradhtuar, e nëpërkëmbur, e përbuzur.

Shpërfillshëm raportohet për takime që përbëjnë lajmin e ditës, e thajse askush nuk bzan për të ikurit, të larguarit, që presin se mbase kësaj here do të kenë të drejtën e votës në vendet ku jetojnë, së paku si çdo vend tjetër i rajonit, si Kosova, si Maqedonia, si Mali i Zi si thajse çdo vend i Evropës.

Kushedi sa peticione janë nënshkruar, kushedi sa herë është folur e shkruar për domosdoshmërinë e pasjes së votës për diasporën shqiptare nëpër botë, por gjithçka është rrokullisur në "kompromiset e mëdha" që ndodhin në minutën e fundit

mes krerëve të politikës dhe diaspora harrohet, si dhe e drejta e tyre për të zgjedhur. Duket se Kryeministri i "lau" duart me diasporën me krijimin e një karrigeje ministrorë që mbahet nga Majko, ku prodhohen disa njoftime e tek tuk ndonjë fotografi, ku duket se edhe vetë Majko gjendet i zënë në çarkun izolues, e s' mund të bëjë asgjë më tepër sesa të gjejë ndonjë fjalë si dritëhije e kompozuar paksa jashtë linje. Dy samite diasporë janë organizuar nga qeveria dhe u kry. Ca foto, ca fjalime miradie për mërgimtarët, për diasporën dhe e ardhmja tingëllon e boshhtë.

Krejt tangent kalojnë çdo lloj lajmi për diasporën sidomos ata që kanë të bëjnë me remitancat, pra paratë që sjell diaspora. E duket se gjithçka tjetër nuk e kap as treditëshin e lajmit, as interesin më të vogël. Shumë shumë, ministria pa portofol e Majkos i fut një "share" në një grup njerëzish që presin se çfarë mund të ndodhë, ndonjëse duket se shumica janë jo thjesht të zhgënjyer, por çdo gjë duket kaq neveritëse, sidomos kur dëgjohen ato fjalët mal-lëngjyese për domosdoshmërinë e votës së diasporës.

Ka një fakt të qartë. Diaspora nuk mund të blihet e as kursesi të manipulohet dhe kjo duket se nuk u shkon për shtat atyre që ndërtojnë strategjitë elektorale, atyre që nuk mund të shqisin të ndenjurat nga karriget e pushtetit, e krejt shpërfillshëm jo vetëm numërojnë por fatkeqësisht rreken "të justifikojnë" të pajustificueshmen. As që u bën përshtypje "sa çon miza në krahe" paralajmërimet e frikshme të institucioneve ndërkombëtare se Shqipëria do të zbrazet, se do të mbetet në 1/2 milion banorë.

Çfarëdo lloj justifikimi për këtë do të kthehet në një bumerang nëse të ikurit, të larguarit, të pashpresët do të kishin të drejtën e votës. Ngjirazi tek-tuk rreken të shtojnë ndonjë fjalë për të ashtuqajturën reformë zgjedhore që retushohet dhe fillon dueli për t'ia hedhur fajin të tjerëve se ne ishim po ata jo, pala tjetër është fajtorë.

Nuk dihet cili mund të ishte justifikimi i qeveritarëve kur sot mungon regjistri i diasporës, pra nuk dihet se sa është numri i shqiptarëve që jetojnë nëpër botë. Ministri Majko publikisht deklaroi 50%, por shkresa nuk ka. Sikur para shtatë vitesh (së

paku) të fillonte regjistrimi i diasporës a do të kishte mbaruar tani?

A do të kishte marrë fund çdo lloj alibie për fajin e të tjerëve? A do të ishte kryer një detyrim që shteti ka ndaj bashkatdhetarëve të vet, një detyrim kushtetues në fund të fundit?

E kushedi sa përgjigje do të merrte pikëpyetja se "Pse kjo frikë nga diaspora"? E krejt tulatshëm rrjedh çdo lajm tjetër përveç të drejtës së diasporës për të votuar, me një prej sistemeve që mund të zgjedhin, qoftë edhe si Kosova, apo cilido vend i rajonit. E kushedi çfarë hipokrizie do të gatuhet deri atëherë, kur të deklamohet se u ra dakord për sistemin zgjedhor, u ra dakord për datën e zgjedhjeve e ku ndoshta askush nuk do të pyetet krejt thjeshtësisht, po diaspora?

Deri atëherë do të serviren lajme të pafundme, ku do të mungojë diaspora, pra gysma, që për qeverinë zhduken sapo lënë Rinasin... ah po, Rinasin aeroportin më të shtrenjtë në rajon dhe më gjerë...

ribotim 16/01/2020

## AVOKATET E EMIGRACIONIT PËR SHQIPTARËT NË UK

**HA** Haris Ali Solicitors

If you are a child born in the UK with no immigration status, after 7 years in the UK you can apply straightaway for indefinite leave to remain (ILR).

Call: 0208 8570 7300 | Mobile: 07967 467414 | [www.harisalisolicitors.co.uk](http://www.harisalisolicitors.co.uk)

19 Kingsley Road, Hounslow, London. TW3 1PA



**Imperium  
Chambers**

**Tel: 0207 242 3488**

**Address: 2 Selkirk Road,  
London SW17 0ES**

Email: [enquiries@imperiumchambers.co.uk](mailto:enquiries@imperiumchambers.co.uk)

Website: [www.imperiumchambers.co.uk](http://www.imperiumchambers.co.uk)

YouTube: The Immigration Barrister

**A JENI MARTUAR PAS DATËS  
31 DHJETOR 2020 DHE JU  
ËSHTË REFUZUAR APLIKIMI  
I EU SETTLEMENT SCHEME  
(EUSS)?**

**DONI TË APELONI ÇESHTJEN  
TUAJ NË SHKALLËN E PARË  
APO TË DYTË TË AELIT?**



**ME NJË GARANCI SUKSESI TË LARTË NË TË GJITHË APELET BARISTERËT TANË TË KUALIFIKUAR  
DHE ME EKSPERIENCË E NDJEKIN ÇESHTJEN TUAJ NGA FILLIMI NË FUND**

**SHERBIMET QE OFROJME NE ÇESHTJET E EMIGRACIONIT PERFSHIJNE**

Human Rights

Judicial Review

Appeals

(we have in house barristers)

Fresh claims

Asylum

Overstayers

Stateless

Detention & Bail

EEA family permit

EEA Permanent Residence

Indefinite Leave to Remain (ILR)

Nationality

Spouse Visa

Visitor Visa

Dependent children

Student,

Work & Entrepreneur Visa

Jemi te specializuar ne aplikimet per nderrimin  
e shtetesise nga **Kosovar** ne **Shqiptar**

**Per me shume informacion kontaktoni Adelen**

Fully accredited by the  
Bar Standard Board



**BAR  
STANDARDS  
BOARD**

Imperium Chambers

4.8 ★★★★★ (141) ⓘ

Lawyer in London, England · [Open](#)

**Mob:**

**07901181592**



ARBEN MANAJ

Ministria e Brendshme britanike ose Home Office ka rritur tarifën për marrjen e vizave dhe çdo lloj leje qëndrimi, deri tek ato të qëndrimit të përhershme dhe ato për aplikimin për pasaportat britanike, ndryshime që pritet të aplikohen nga data 4 tetor e këtij viti.

Në bazë të këtyre ndryshimeve, kostoja e një vize vizitorësh për një periudhë prej me pak se gjashtë muajsh do rritet nga 15 sterlina në 115, ndërsa tarifa për një vizë studentore e bërë jashtë territorit britanik do rritet nga 127 sterlina aktualisht në 490 në muajin tetor, duke u barazuar me tarifën e aplikimit të bërë kur studenti ndodhet në Britani.

Ndryshimet e tarifave përfshijnë vizat britanike 6 mujore, 2, 5 dhe 10

## SHTRENJTOHEN VIZAT E LEJE-QËNDRIMET! QEVERIA BRITANIKE UA FATURON KOSTOT TË HUAJVE

vjeçare, shumicën e tarifave për vizat dhe lejet e qëndrimit si për arsye pune ashtu edhe studimi, tarifën për lejet e përhershme të qëndrimit si dhe ato për aplikimet për të regjistruar si i natyralizuar për të marrë shtetësinë britanike. Avokati i njohur shqiptar në Londër, Naim Hasani, thotë për Top-Channel, se tarifën kanë qenë goxha të larta dhe tanimë do rriten akoma më shumë.

Rritja e tarifave bëhet për të lehtësuar barrën e taskapaguesve britanikë në funksionimin e shërbimeve të emigracionit, si dhe për të financuar rritjet e pagave për britanikët që punojnë në sektorin publik, duke ua kaluar këto kosto të huajveve që duan të jetojnë, punojnë apo studiojnë në Britani.

### *Morën peng italianin, dënohen 4 shqiptarët*

Katër shqiptarë janë burgosur në Britaninë e Madhe, pasi rrëmbyen një shtetas italian sepse nuk iu kishte bërë pagesën për një borxh të supozuar të

drogës.

Media britanike Sky News, të cilës Top Channel i referohet, raporton se italianin rreth të 30-tave, u mbajt për 36 orë kundër dëshirës së tij në një apartament në Cricklewood, në veriperëndim të Londrës, pasi u josh nga shqiptarët një lokal në shkurt të këtij viti.

Ndërsa ishte atje, ai bëri disa telefonata me ish-partneren dhe miqtë e tij për ta ndihmuar të paguante 110,000 £, pasi po ia kërkonin në lidhje me një borxh droge që i detyrohej mikut të tij. Kur policia kishte hyrë në banesë më 18 shkurt, e gjeti të riun të gjakosur me disa plagë thike dhe mavijosje.

Pamjet e telefonit celular të gjetur më vonë nga oficerët treguan italianin duke u kërkuar rrëmbyesve të tij që të mos e vrisnin. Ervis Ademi, Xhekson Malollari, Mariglen Elezi dhe Hydajet Kadriu janë të gjithë të burgosur. Malollari dhe Elezi u shpallën fajtorë për komplot për rrëmbim, ndërsa Elezi u shpall fajtor edhe për posedim të një sasive të vogël kokaine.

Dy nga grupi i katër shqiptarëve e

çuan viktimën në një bar në Cricklewood Broadway për t'i marrë borxhin e drogës. Pas disa bisedimeve ata u larguan nga bari të tre së bashku, dhe ndërsa ishin duke ecur në rrugën Richborough, dy shqiptarët e tjerë të veshur me kapuç u afruan përballë, e mbërthyen me forcë italianin dhe e futën në një makinë. Nga aty, grupi u largua për të gjetur strehë në një banesë në Dean Road, ku dhanuan fizikisht viktimën, dhe i lanë atij prekje me thikë në trup gjatë përlëshjes. Pasi italianin u bëri thirrje miqëve të tij për pagesën, policia u vu në dijeni për rrëmbimin dhe filloi të vëzhgonte banesën në orën 2 të mëngjesit të datës 18 shkurt në kuadër të Operacionit Major.

Rreth orës 12:30, policia e armatosur ka hyrë në banesë dhe ka arrestuar Malollarin dhe Elezin. Ademi dhe Kadriu u arratisën por u kapën dhe u arrestuan jashtë ndërtesës.

Detektivi Tom Waller, i cili udhëhoqi hetimin, tha se: "Ky rrëmbim ishte një sulm i tmerrshëm i planifikuar ndaj

një personi."

Pas arrestimit të shqiptarëve, oficerët kërkuan prova në banesë, ku gjetën kapuçet, sende të lyera me gjak, telefona celularë dhe çelësat e një makine që kishte qenë në skenën e rrëmbimit. Pamjet e kamerave të lokalit tregonin Malollarin si një nga personat që takoi viktimën te bari. Po ashtu, pamjet e kamerave të sigurisë të marra nga një biznes aty pranë treguan të njëjtën makinë në vendin e rrëmbimit, e cila ishte parkuar jashtë banesës në Dean Road.

Sipas policisë kishte edhe disa foto dhe mesazhe inkriminuese në telefona, si dhe një video tregonte viktimën e plagosur, duke iu përgjigjur pyetjeve për paratë dhe lutur për jetën e tij. Ademi dhe Malollari u dënuan në Gjykatën e Kurorës së Amersham të premtën, më 22 shtator, me 10 vite burg.

Elezi dhe Kadriu u dënuan me nga katër vjet burgim.

HA  
HARIS ALI SOLICITORS

## KONSULTIMET FALAS

OFFICE: 020 8570 7300 / MOBILE: 07967 467414

We are **Immigration Experts** who have a high success rate in representing thousands of **Albanian** clients with a variety of immigration issues. We have a highly experienced team of immigration solicitors and barristers.

- Asylum / Trafficking
- Overstayers / Human Rights
- Detention & Bail
- Appeals & Judicial Review
- Fresh Claims / Further Submissions
- Indefinite Leave To Remain / Nationality
- EEA Permits / Stateless / Deprivation
- Spouse Visas / Children's Visas

Email: [contact@harisalisolicitors.co.uk](mailto:contact@harisalisolicitors.co.uk)

19 Kingsley Road, Hounslow, London, TW3 1PA | [www.harisalisolicitors.co.uk](http://www.harisalisolicitors.co.uk)

# LEXMARK LEGAL

EKSPERTËT TUAJ TË BESUAR NË LIGJIN E  
EMIGRACIONIT

## A PO KËRKONI NDIHMË PROFESIONALE PËR ÇËSHTJET E EMIGRACIONIT?

Mos kërkoni më tej! Lexmark Legal është ekipi juaj i kërkuar i avokatëve ekspertë të imigracionit në Londër, të përkushtuar për të ofruar zgjidhje ligjore të nivelit të lartë të përshtatura për nevojat tuaja.



## PSE TË ZGJIDHNI LEXMARK LEGAL?

- Profesionistë me përvojë të imigracionit
- Zgjidhje ligjore të personalizuar
- Ekspertizë e shumëanshme
- Përkushtuar për suksesin tuaj
- Qasje e dhembshur dhe e kujdesshme

Gati për të ndërmarrë hapin e parë drejt zgjidhjes së shqetësimeve tuaja ligjore? Kontaktoni avokatët e imigracionit ligjor të Lexmark dhe na lini të jemi partneri juaj ligjor i besuar.


## CONTACT US

ANA: 07435119343

ALDO: 07494181220

SANTJOLA: 07742877853

OFFICE: 0208 090 2488

 The Winning Box, Aquis House, 27-37 Station Road, Hayes, UB3 4DX

## SHËRBIME TË REJA:

- 1. Mbështetja e Legjislacionit Civil:**  
Lundrimi përmes legjislacionit civil mund të jetë kompleks, por mos u shqetësoni! Profesionistët tanë të kualifikuar ligjorë janë këtu për t'ju udhëhequr në çështje të ndryshme të së drejtës civile. Nga mosmarrëveshjet e kontratave të drejtat pronësore, ne ju kemi mbuluar me këshilla dhe përfaqësim gjithëpërfshirës.
- 2. Ndihmë e dhembshur për të drejtën e familjes:**  
Ne i kuptojmë ndjeshmëritë e përfshira në çështjet e së drejtës familjare. Qoftë divorci, kujdestaria e fëmijës ose birësimi, ekipi ynë empatik është i përkushtuar për t'i zgjidhur çështjet familjare me kujdes, duke siguruar rezultatet më të mira të mundshme për ju dhe të dashurit tuaj.
- 3. Shërbime të fuqishme të mbrojtjes kriminale:**  
Kur përballeni me akuza penale, të kesh një mbrojtje të fortë ligjore është thelbësore. Avokatët tanë me përvojë janë njohës të mirë të ligjit penal dhe të përkushtuar për të mbrojtur të drejtat tuaja. Nga konsultimet ligjore të përfaqësimi në sallën e gjyqit, ne jemi këtu për të luftuar për drejtësinë tuaj.

# ÇËSHTJET CIVIL LITIGATION

**ANXHELA SEJDINI**  
*ASHTON ROSS LAW*

Edhe pse shumica prej nesh do të donin të shmangnin mosmarrëveshjet dhe konfrontimet, ndonjëherë ndodhin mosmarrëveshje. Ndërsa disa konflikte mund të zgjidhen miqësisht; Avokatët herë pas here mund të kenë nevojë të udhëzohen dhe procedurat gjyqësore mund të jenë të nevojshme. Ne kemi një përvojë të kon-

siderueshme në trajtimin e të gjitha llojeve të gjyqeve civile dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

Ne mund të ndihmojmë me një sërë rastesh duke përfshirë veprimet kundër Zyrës së Brendshme, mosmarrëveshjet e rimëkëmbjes së borxhit, njoftimet e dënimit, shkeljen e kontratave dhe çështje të tjera të përgjithshme.

Ne gjithmonë kërkojmë të zgjidhim të gjitha mosmarrëveshjet në mënyrë sa më të shpejtë dhe efikase që të jetë e mundur për të kursyer klientët tanë kohën dhe kostot e

tyre. Procedimi në Gjykatë është një mundësi përfundimtare dhe një mundësi që ne gjithmonë kërkojmë ta shmangim.

Ne kemi një histori të jashtëzakonshme të fitimit të çështjeve të kontestuara për shkak të strategjisë sonë të përgjithshme për t'i mbajtur rastet të drejtpërdrejta dhe të thjeshta.

Nëse dëshironi të rezervoni një konsultim në lidhje me një çështje gjyqësore civile ose çështje të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, ju lutemi telefononi Anxhelën në: 07578931363



## RAF SCAMPTON: HOME OFFICE URDHËROI TË NDALONTE PUNËN NË QENDRËN E AZILIT

Zyra e Brendshme është urdhëruar të ndalojë punën për shndërrimin e një ish-baze të RAF në një qendër azili për shkak të shqetësimeve që kushtet e planifikimit janë shkelur.

Qeveria planifikon të strehojë deri në 2,000 njerëz në RAF Scampton në Lincolnshire, me 50 të parët që do të mbërrijnë në vend brenda javësh.

Pas një vizite në terren, Këshilli i Qarkut West Lindsey tani ka dhënë një njoftim për zbatimin dhe një njoftim ndalimi.

Zyra e Brendshme tha se ishte e bindur se projekti i saj përmbushte kërkesat e planifikimit.

Sidoqoftë, këshilli tha se ishte “e qartë” se kishte pasur “një shkelje të kontrollit të planifikimit”

Ai tha se shkelja lidhet me ndërtesat e saj të listuara dhe arkeologjinë në vend, i cili dikur ishte shtëpia e Skuadronit 617 përgjegjës për bastisjet e Dambusters në 1943.

Këshilli, i cili është autoriteti vendor i planifikimit, kishte ngritur shqetësime për punën që po ndodhte dhe fillimisht lëshoi një njoftim për ndalim të përkohshëm më 8 shtator.

Sipas kushteve të njoftimit, Ministria e Brendshme duhet të ndalojë përdorimin e sitit si strehim për azilkërkuesit, të ndërprerë punimet në lidhje me ndërtesat portative, të ndalojë të gjitha punimet ndërhyrëse dhe të rivendosë sitin në gjendjen e tij origjinale.

Titulli i imazhit, Ish-stacioni i RAF po shndërrohet për të strehuar deri në 2000 azilkërkues

Në një deklaratë, këshilli tha se shkelja e kontrollit të planifikimit përfshin ndryshimin e përdorimit të vendit për të akomoduar azilkërkuesit dhe vendndodhjen e akomodimit të



përkohshëm për strehimin e azilkërkuesve.

Sally Grindrod-Smith, drejtore e planifikimit, rigjenerimit dhe komuniteteve në Këshillin e Qarkut West Lindsey, tha: “Në vizitën në terren javën e kaluar, oficerët vëzhguan punime të rëndësishme në vend, të cilat nuk u konsideruan si pjesë e kërkesës për shqyrtimin e vlerësimit të ndikimit mjedisor të Zyrës së

Brendshme.

“Kjo do të thotë se ndikimi i zhvillimit nuk është vlerësuar siç duhet.”

Zonja Grindrod-Smith shtoi se sipas kushteve të Urdhrit të Planifikimit të Qytetit dhe Vendit, “të drejtat e zhvillimit të lejuara urgjente... janë të disponueshme për qeverinë vetëm në një rast urgjence të vërtetë, e cila nuk

është provuar, dhe kur një ekzaminim i vlerësimit të ndikimit negativ në mjedis. vendimi është në fuqi”.

“Përveç kësaj, nga shkalla e punimeve në terren është e qartë se ky zhvillim nuk kufizohet në një periudhë të përkohshme prej 12 muajsh”, tha ajo.

Udhëheqësi i Këshillit West Lindsey, Trevor Young, tha: “Është tepër

zhgënjyese që pavarësisht garancive të përsëritura se siti do të ishte i sigurt, ligjor dhe në përputhje, Zyra e Brendshme nuk ka arritur të sigurojë lejen e duhur të planifikimit ose të vlerësojë në mënyrë adekuate ndikimin e propozimeve të tyre.

“Është një shkelje të biesh në kundërshtim me Njoftimin e Ndalimit dhe i bëj thirrje Home Office të ndërprerë të gjitha punët në përputhje me këtë veprim ligjor.”

Një zëdhënës i Zyrës së Brendshme tha: “Shpërndarja e akomodimit në objektet e tepërta ushtarake ofron strehim më të lirë dhe më të rregullt dhe të përshtatshëm për ata që mbërrijnë me varka të vogla, ndërkohë që ndihmon në reduktimin e përdorimit të hoteleve.

“Ne kemi besim se projekti ynë, i cili do të strehojë azilkërkuesit në strehim bazë, të sigurt dhe të sigurt, i plotëson kërkesat e planifikimit.”

Këshilli tha se kishte pritur që vendi të ishte plotësisht funksional si një shtëpi për emigrantët deri në dhjetor të këtij viti.

Autoriteti humbi një ofertë urdhri në maj për të ndaluar masën, por në korrik iu dha leja për të sjellë një sfidë në Gjykatën e Lartë.

Tashmë është konfirmuar një datë e Gjykatës së Lartë për shqyrtimin gjyqësor, i cili do të zhvillohet në 31 tetor dhe 1 nëntor.



ASHTON ROSS LAW

# EMIGRACIONI

Çdo çështje është unike dhe për kete arsye ne kemi krijuar një reputacion për ofrimin e këshillave dhe shërbimeve të emigracionit më të shkëlqyer.

Ne kemi një shkallë të lartë suksesi në çështjet që marrim përsipër. Llojet e çështjeve që marrim përsipër janë:

- Immigration Appeals
- Judicial Review
- Administrative Review – rishqyrtim vendimi
- British Citizenship deprivation
- Indefinite Leave to Remain
- Family and Dependant related visa applications for children, spouses and fiancés
- Dependant visa

**CALL NOW**

T: 075 7893 1363

1 Quality Court, London,  
WC2A 1HR

[www.ashtonrosslaw.com](http://www.ashtonrosslaw.com)



Për çdo pyetje në lidhje me emigracionin, kontaktoni Anxhelën në numrin e telefonit: 07578931363.

## HUMAN RIGHTS

- EU Settlement Scheme
- Detention & Bail
- Private and Family life
- Naturalisation
- Asylum
- Visa Extensions
- Sponsorship licence
- Switching Visas

## Çështje familjare

- Divorce
- Adoption
- Child Arrangement Orders
- Parental Responsibility
- Orders
- Premarital agreements
- Postmarital agreements





## DAUT DAUTI

*Shërbimet sekrete në vendet socialiste, ku përfshihet Jugosllavia dhe Shqipëria, kanë pasur qëllime tjera nga ato të Perëndimit. Shërbimet socialiste kanë përhapur më shumë frikë te popullata se që e kanë ruajtur vendin nga "armiku". Me këtë frikë është tentuar ruajtja e pushtetit komunist dhe për këtë arsye KGB-ja, UDB, STASI, Sigurimi e ndonjë tjetër kanë qenë të tmerrshme për popujt e këtyre vendeve.*

Zgjedhjet e vitit 1997 sollën ndryshime të mëdha shoqërore dhe politike në Britani të Madhe. Në pushtet erdhi një frymë e re laburiste me kryeministër Tony Blairin, i cili për sekretar të brendshëm, pozitën e dytë më të rëndësishme në qeveri, e emëroi aktivistin e dalluar partiak, Jack Straw. Dy vite më vonë (1999) doli në shesh një informatë, që për publikun e gjerë mund të ishte habi, por jo për një grup të ngushtë të laburistëve. Një ish agjenti i shërbimit sekret britanik në pension bëri me dije se MI5 kishte dosje për Jack Straw. Dosja ishte e viteve të '70-ta, kur Jack Straw ishte student i drejtësisë në University of Leeds. Sipas dosjes, Strawi në ditët e tija studentore, kur ishte edhe kryetar i unionit të studentëve dhe majtist, kishte ushtruar "aktivitet politik subversiv". Pra, ishte ngritur një dyshim serioz kundër tij. Si shtesë, agjenti deklaroi se informatat për dosjen e tij ishin mbledhur në mënyrë jo të besueshme dhe joligjore. Por, në këtë botë gjërat ndryshojnë aq shumë, sa që tashti Jack Straw, duke qenë sekretar i punëve të brendshme, ishte edhe shef i sigurimit sekret MI5. Tashti, ky shërbim e kishte pyetur Jack Strawn, shefin, nëse dëshironte ta shihte dosjen. Straw ishte përgjigjur negativisht dhe mes tjerash kishte shtuar: "Mendoj se ndaj kësaj dosje unë nuk duhet të kem të drejta më shumë se ndonjë qytetar tjetër në këtë pozitë".

Por, arsyeja e vërtetë që Straw nuk e shikoi dosjen e tij, mund të jetë fakti që doli më vonë në shesh. Vet Straw, sa ishte këshilltar i kryeministrit



Harold Wilson, e kishte lexuar dosjen e dashnores së udhëheqësit liberal, Jeremy Thorpe. Kjo ishte bërë "për çështje sigurie", por në realitet ishte për shikim të mundësisë së diskreditimit të rivalit politik. Straw në viti 2018 e tregoi këtë rast dhe deklaroi se ishte tronditur nga përmbledhja e detajeve më të imta të jetës, përfshirë edhe marrëdhëniet seksuale. Kjo ishte e padrejtë, sipas tij, dhe ndoshta Straw nuk ka dashur t'i shoh detajet e ngjashme edhe në dosjen e tij.

Kur flitet për shërbimin sekret britanik, ne e dimë që fjala është për agjencinë më të justifikuar të spiunazhit në botë. Por, edhe kjo agjenci drejtohet nga qeveria, që do të thotë se mund të keqpërdoret nga politika për qëllime të kundërta për të cilat është formuar dhe duhet të funksionojë. Sa jemi te ky shërbim, duhet përmendur edhe një rast. MI6 është shërbim për siguri jashtë shtetit britanik, kurse MI5 për sigurinë e brendshme. Në arkivin shtetëror britanik (National Archives) që gjendet në Londër, ekzistojnë dy dosje të cilat MI6 i ka përpiluar. Njëra dosje që titullohet "Albanian Nationalism in Yugoslavia" (Nacionalizmi Shqiptar në Jugosllavi) dhe është e hapur, por nuk ofron shumë gjëra nga ato që dihen, ndërsa dosja tjetër, e përmbledhur nga MI6, me titull "Activities of the Yugoslav Dissidents" (Aktivitetet e Desidentëve Jugosllavë), duket se përmban shumë sekrete, pasi që ka të bëjë me aktivitetin e desidentëve jugosllavë dhe aktivitetin e UDB-së

kundër këtyre grupeve në Europë. Kjo duhet të jetë interesante, pasi që dihet që ka të bëjë me vrasjen e desidentëve kroatë dhe shqiptarë. Kësaj dosjeje nuk do t'i hiqet embargoja deri në vitin 2040-të.

Arsyeja e moshapjes së dosjes në fjalë është se 'Ligji mbi Mbrojtjen e të Dhënave (1998) në Britani të Madhe e ndalon hapjen (publikimin) e informatave personale nëse ato janë kundër arsyes së mbledhjes së tyre ose nëse subjekti (MI6) zyrtarisht ka bërë me dije se hapja e tyre mund të dëmtojë ose të shkaktojë rrezik ndaj jetës së personave që përmenden apo mund të shqetësojë shoqërinë dhe të destabilizojë edhe situatën politike.

Kështu është me dosjet e shërbimit sekret në Britani të Madhe, ku kësaj pune i kushtohet kujdes i madh. Megjithatë, siç u pa më lart, politikanët edhe në këtë vend, mund t'i (keq) përdorin këto dosje.

Tashti, pyetja që parashtrrohet në lidhje me keqpërdorimin e dosjeve në Serbi, Maqedoni të Veriut dhe Shqipëri është esenciale. Kosova duhet të përjashtohet nga ky rast, për arsye se nuk ka dosje për të kaluarën, sepse ato i ka marrë Serbia. Por, ky është një problem tjetër, ndoshta edhe më i madh, për arsye se dosjet që ekzistojnë mund të përpunohen në Beograd, me qëllim që të shkaktohet ndonjë pasojë te ndonjë individ ose grup individësh, e cila gjë pastaj krijon reflektime edhe më gjerë në

shoqëri. Intervenimi i pushteteve të sotme ose i individëve në dosjet ekzistuese të kohës së socializmit në shumë raste është bërë me dije nga shtypi se ka ndodhur në Beograd e Tiranë.

Shërbimet sekrete në vendet socialiste, ku përfshihet Jugosllavia dhe Shqipëria, kanë pasur qëllime tjera nga ato të Perëndimit. Shërbimet socialiste kanë përhapur më shumë frikë te popullata se që e kanë ruajtur vendin nga "armiku". Me këtë frikë është tentuar ruajtja e pushtetit komunist dhe për këtë arsye KGB-ja, UDBa, STASI, Sigurimi e ndonjë tjetër kanë qenë të tmerrshme për popujt e këtyre vendeve. Pos tmerrit, këto vende me këto shërbime kanë shpërndarë edhe informatat apo dezinformatat për lansimin e ideve dhe përgatitjen e dëgjueshmërisë së masave.

Shërbimet sekrete të vendeve të ndryshme bashkëpunojnë, deri në një masë, në shkëmbimin e informatave. Nuk është për t'u habitur nëse një bashkëpunim i tillë ka ekzistuar mes UDB-së dhe Sigurimit të Shqipërisë socialiste. Por, ajo që është më e rëndësishme është fakti i infiltrimeve që shërbimet bëjnë në njëra-tjetrën. Ekziston një lloj gare për këto infiltrime, për shkak se aty janë informatat.

Puna ose rezultati i shërbimeve sekrete nuk dihet kurrë plotësisht. Kjo është për arsye se kjo veprimtari nuk

është publike dhe shumë dosje nuk hapen kurrë. Në arkivat e të gjitha vendeve mungojnë dosjet, së paku të kohës së një shekulli, nga të cilat historianët do të kishin qasje në to. Informatat kryesore merren nga njerëzit që kanë punuar në këto shërbime dhe që shkruajnë libra për këtë gjë. Ta zëmë, organizimi dhe veprimtaria e KGB në Europë u bë me dije, në masë të madhe, kur Vasili Mitrokhin, shef i departamentit për zbulime të jashtme, iku në Angli si agjenti i dyfishtë që ishte. Pastaj, ai e botoi librin e tij "The Mitrokhin Archive" dhe publiku u njoh me natyrën e KGB-së.

Në Shqipëri dhe vendet që dolën nga ish Jugosllavia është më se e nevojshme hapja e dosjeve dhe studimi serioz shkencor i UDB-së dhe Sigurimit. E kaluara ka qenë e vështirë dhe njohja e kësaj pune do ta lehtësonte të ardhmen. Por, sërish pyetja që shtrohet është: si bëhet kjo punë që është shumë e vështirë?

Ajo që dihet është se njerëzit që kanë punuar në shërbime sekrete të vendeve socialiste kanë përparuar me shpejtësi të madhe në shoqërinë postkomuniste. Ata sot janë njerëzit më të pasur dhe më me pushtet që nga Rusia e deri në Shqipëri. Kjo është për shkak se këta njerëz kanë disponuar me armën më të fuqishme: informatën sekrete. Me këtë "armë" ata e kanë ditur rrugën dhe i kanë kërcënuar pengesat, kurse viktimat kanë mbetur viktimat.

# qccl

Excellence Redefined

- » AZIL / TRAFIKIM
- » MBARIM I LEJES SE CENDRIMIT /  
TE DREJTAT E NJERIUT
- » PARABURGIMI DHE LIRIMI ME  
KUSHT
- » ANKESA DHE SHQYRTIMI  
GJYQËSOR
- » PRETENDIME TË REJA /  
PARASHTRESA TË METEJSHME
- » LEJE QËNDRIMI TË PACAKTUAR
- » KOMBËSIA
- » LEJET TE BASHKIMIT EVROPIAN
- » PA SHTETËSI
- » PRIVIMI
- » VIZAT E BASHKËSHORTIT
- » VIZA PER FËMIJE
- » KULTIVIMI I BARNAVE TË KLASIT  
B/A TE DROGES
- » URDHËR DEPORTIMI
- » KUNDERVAJTJET E DREJTIMIT TË  
AUTOMJETIT
- » SULM / BATERI / GBH



## Pse na zgjedhet ne?

Ne jemi krenarë te mburremi me nivelet kryesore të suksesit të rasteve në industri brenda sektorëve të tillë si ligji i imigracionit, dhe do ta sjellim atë këmbëngulje dhe njohuri si per çdo rast që na udhëzon. Ne kemi ndërtuar një kulturë dinamike dhe etikë pune që na mban përpara konkurrentëve tanë. Specialistet tanë juridikë të ndryshem dhe ndërkombetare qendrojnë të informuar për të gjitha ndryshimet ligjore dhe rregullatore dhe do të sigurojnë që ne të veprojmë gjithmonë me interesat tuaja më të mira.

### » Laurenta Lata-Emsha

☎ 07483 159 608

✉ [laurenta@queenscourtlaw.co.uk](mailto:laurenta@queenscourtlaw.co.uk)

### » Aldrina Sopa

☎ 07483 308 282

✉ [aldrina@queenscourtlaw.co.uk](mailto:aldrina@queenscourtlaw.co.uk)

### » Endrit Maliqi

☎ 07483 345 245

✉ [endrit@queenscourtlaw.co.uk](mailto:endrit@queenscourtlaw.co.uk)

Main office

📍 1st Floor, One Finsbury Square,  
London EC2A 1AE



SONILA MEÇO

Në një të diel të zakonshme shtatori, 15 vite pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe 24 vite nga Marrëveshja e Kumanovës, që i dha fund luftës, nga një manastir në Banjskë të Leposaviçit, ku ishte fortifikuar arsenal luftar, u përvijua një sulm terrorist ndaj policisë së Kosovës, që la pa jetë rreshterin e policisë Afrim Bunjaku dhe plagosi policin Alban Reshiti.

Ishin serbët, që bojkotuan institucionet dhe zgjedhjet në veri, ishin kriminelë serbë ata, që sulmuan ushtarët e KFOR-it pak javë më parë, ishin skuadrat speciale të Serbisë, që rrëmbyen 3 policë të Kosovës dhe sot nga çfarë dallohet prej informacioneve paraprahe arsenal luftar i ka hyrë në trup Kosovës, përballur me vendosmëri nga forcat e veta, si shtet i pavarur, duke "lindur" heronj në kohë paqeje.

D.m.th Kosova merr pjesë në paqe, nënshkruan pavarësinë me ndërhyrjen ndërkombëtare, respekton marrëveshjet, pa nisur kriza të njëanshme, reagon si shtet i pavarur, herë me reciprocitet, por gjithmonë me institucione, ama kurrë prodhuese krizash...



Dhe kur faktori ndërmjetësues ndërkombëtar, vendoset fort nën lupën e diplomatëve, akademikëve,

studiuesve, politikanëve perëndimorë duke u konsideruar i njëanshëm, tejet tolerant ndaj Vučić, i pamundur

# TIRANA ZYRTARE, KJO E PABINDUR KRONIKE

karshi provokimeve e përpjekjes së Beogradit për destabilitet, politikanë e udhëheqës shqiptarë gjejnë arsye të kritikojnë Prishtinën zyrtare në rastin më të mirë a të thërrasin gjer në ngjirje për një Konferencë Paqeje në më të keqin duke vendosur sërish kandin në raportet Kosovë-Serbi me një egoizëm absurd (nuk dua të shkruaj "shërbim" ndaj Beogradit si profeci vetpërbushëse).

Absurde...sepse Kosova i gjeget çdo provokimi, sulmi a denigrimi me stof shtetar, gjë që nuk e bën dot Tirana zyrtare. Tirana zyrtare, që gjakoset në zgjedhjet e veta, që kupolën e policisë e shkërmoqi në fushata kanabizimi, që eksponentë të organeve ligjzbatuese i vihen në dispozicion kriminit të organizuar, që korrupton FBI...Kjo Tiranë zyrtare, që 111 vjet pavarësi nuk i mjaftuan të bëjë shtet sa Kosovës 15 vjeçare i kërkon botës një Konferencë Paqeje për Kosovën, asaj Kosove, që ia toleron me durim edhe projekte shkëmbimesh terrioresh,

edhe "Ballkanin e Hapur", edhe kundërvënien ndaj saj me deklarata qesharake, por të rrezikshme.

Kosova sot ka nevojë të njihet si shtet i pavarur së pari nga institucionet e Tiranës zyrtare. Mandej me kryerjen jo vetëm formale të këtij akti, të varet preambula kushtetuese në çdo qafë politikani e zyrtari për rolin e Shqipërisë në raport me Kosovën.

Dhe se është e lodhshme, e pado-bishme, krejt e dobët dhe e manipulueshme, metaforikisht dhe literalisht qesharake çdo përpjekje normalizimi raportesh kur ndërmjetësuesit vijjnë nga vende, që nuk e kanë njohur ende pavarësinë e Kosovës. Kjo i bën lehtësisht të "tretshëm" nga reaksione lobimi. Shqipëria ç'është di mirë me vepra nga këto lojëra.

Sot Kosova i do të gjithë me të, për fat dallohet si me letër lakmuesi kush shqipfolës anëmbanë ia do të mirën e kush po don me e kry pazarin e radhës.



## Apollonia Transport

TRANSPORT MALLRASH  
ANGLI - SHQIPERI  
SHQIPERI - ANGLI



SHQIPËRI

Tiranë - Durres-Elbasan-Berat  
Fier-Vlorë-Roskovec-Ballsh



BRITANI

Londër - Birmingham  
Manchester - Leeds - Luton

NA KONTAKTONI

UK: 00447429200952  
AL: 00355682948843  
AL: 00355694031009



Acropolis  
Transport



UNITED KINGDOM - GREECE  
GREECE - UNITED KINGDOM

CONTACT US

GR: 00306948218963

UK: 00447342514490



ANGLIA-ELLADA



Igomenica - Ioannina-Agrinio-Arta-Patra  
Kiato-Korintho-Pelloponiso Kalamata-Athina



London-Sheffield-Leeds  
Manchester - Birmingham  
Northampton-Luton



ELLADA-ANGLIA



Xalkidha-Lamia-Volos-Larisa-Katerini  
Thesaloniki-Aleksandria-Gianitsa  
Veria-Kozani-Grevena-Igoumenitsa

Email: acropolistransport84@gmail.com

# VAL CLINIC

NESE JU DUHET NJE DOKTOR  
MOS HEZITONI TE VIZITONI  
VAL CLINIC

THE BEST MEDICAL CENTER

## OUR SERVICES:

CARDIOLOGY  
ENT  
PAEDIATRICS  
GYNAECOLOGY  
DERMATOLOGY  
INTERNAL MEDICINE  
RADIOLOGY  
PHYSIOTHERAPY  
NEUROLOGY  
SURGERY AND MINOR INJURY  
UROLOGY  
ENDOCRINOLOGY  
GASTROENTEROLOGY  
AESTHETIC MEDICINE  
PODIATRY  
FULL CHECK-UP  
PSYCHOLOGY  
PSYCHIATRY  
DIAGNOSTICS:  
ALL TYPE OF BLOOD TEST  
AND SWABS AFTER  
DOCTORS  
CONSULTATION



PERSHENDETJE,  
JAM DR. ARJOLA DHE PUNOJ  
NË VAL CLINIC QË ËSHTË NJË  
KLINIKË NË LONDËR ME  
MJEK/E SPECIALISTË TË  
GJITHË SHERBIMEVE  
MJEKESORE. PËR ÇDO  
PROBLEM NA KONTAKTONI

NA KONTAKTONI



INFO@VALCLINIC.CO.UK  
WWW.VALCLINIC.CO.UK

39 Frederick Road  
Rainham RM13 8NJ  
Tel: 01708701155  
Mob: 07307595437



MERITA AVDYLI

Me 14 shtator 2023, Shpresa Programme organizoi një eveniment të rëndësishëm në njërin nga sallat e 'House of Commons', Westminster, ku mblodhi së bashku individë të pasionuar drejt udhëheqjes për ndryshimet pozitive.

Evenimenti u hap nga Jonathan Ellis dhe Lediana Pajaj, të cilët ju uruan mirësedardhjen të gjithë pjesëmarrësve, duke krijuar skenën për një pasdite frymëzuese të mbushur me aktivitete domethënëse.

Në mesin e folësve të nderuar të ftuar ishin: Sir. Stephen Timms, Deputet i Parlamentit i cili ka qenë një mbështetje e madhe për Shpresën dhe komunitetin shqiptar këtu në Londër. Ai ndau me ne qasjen e tij unike ndaj lidershit. Folësja e dytë e ftuar ishte Zëvendës - Ambasadorja e Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar Znj. Mamica Toska e cila ndau njohuritë e saj mbi udhëheqjen e komunitetit dhe angazhimin e saj për të krijuar një botë më të mirë.

Në vazhdim fjalë urtësie dhe frymëzimi na percolli e nderuara Luljeta Nuzi - CEO e Shpresa Programme. Gjithashtu ishim të privilegjuar të dëgjonim nga z. Alastair Wilson, i cili ndau me ne njohuri të vlefshme për vizionin e SSE dhe mundësitë e jashtëzakonshme që ato ofrojnë për programin tonë të lidershit. Nuk munguan fjalët përshendetëse edhe nga të ftuar të tjerë.

Unë ndihem e nderuar që mora pjesë në programin e lidershit të ofruar nga organizata Shpresa. Kanë qenë nëntë muaj të jashtëzakonshëm të mbushur me përvoja transformuese, mësim të vlefshme dhe miqësi të qëndrueshme.

Ndërsa mendoj për udhëtimin tim, dua të ndaj përvojën time për të frymëzuar grupin e dytë të lidershit dhe për të shprehur vlerësimin tim të thellë për mbështetjen që mora gjatë programit në grupin e parë.

Udhëtimi ynë filloi me shpresa të mëdha dhe një etje për dije që na ndihmon të kuptojmë dhe adresojmë më mirë çështjet dhe sfidat sociale. Përgjatë një sërë trajnimesh intensive dhe takime plot vlerë, prezente kishim edhe themeluesen e Shpresa Programme, Luljeta Nuzi.

Ajo ne fillim ndau përvojat e saj gjatë udhëtimit 20 vjeçar si drejtuese e Shpresa Programme ku edhe theksoi rëndësinë e qëndrueshmërisë dhe vendosmërisë për një leadership të suksesshëm. Luli është forca shtytëse e

# REFLEKTIM MBI UDHËTIMIN TIM TË LIDERSHIPIT ME SHPRESA PROGRAMME!



ketij programi bashke me Jonathan Ellis nga i cili patëm privilegjin të mësonim.

Përkushtimi i tyre në këtë program na bëri të përvetësojmë disa nga cilësitë e duhura në zhvillimin e komunitetit. Seancat vazhduan edhe me profesionistë të tjerë të aftë nga SSE (Shkolla për Ndërmarrësit Social). Ekspertizat e tyre ishin të rëndësishme në formësimin e këndvështrimeve tona dhe në pajisjen tonë me mjetet dhe mundësitë për të bërë një ndikim me vlerë në shoqëri.

Një nga temat e fuqishme që më bëri jehonë gjatë gjithë programit ishte ideja për t'i kthyer ëndrrat në realitet. Ne u inkurajam të nxjerrim në pah ëndrrat tona, dhe më e rëndësishmja, të ndërmarim hapa konkretë drejt arritjes së këtyre ëndrrave. Ishte një kujtesë se liderishi nuk është vetëm të kesh një vizion, por edhe të ndërmarësh veprime për ta sjellë në jetë atë vizion.

Një mësim tjetër jetësor ishte shndërimi i zemërimit në drejtësi. Në një

botë të mbushur me sfida dhe padrejtësi, ne mësuam se si t'i kanalizojmë emocionet tona në rrugë konstruktive për ndryshim.

Ky transformim është thelbi i lidershit - duke përdorur pasionin dhe zemërimin tonë si ushqyes për të nxitur ndryshime pozitive dhe domethënëse në komunitetin tonë. Po aq i rëndësishëm ishte edhe kërkimi ynë për t'i kthyer problemet në zgjidhje.

Në vend që të pushtoheshim nga pengesat, ne u këshilluam t'i shihnim ato si mundësi për ndryshim. Ky ndryshim i të menduarit na fuqizon t'u qasemi sfidave me kreativitet dhe inovacion, duke çuar përfundimisht në zgjidhjet e duhura nga të cilat shoqëria mund të përfitojë.

Një nga pikat kryesore të programit ishte diskutimi i udhëtimit të - mentorit dhe të mentoruarit gjatë rrugëtimit të lidershit - Mentorin im Jonathan dhe unë, së bashku me Shelly dhe Carmelo, ndamë udhëtimet tona të jashtëzakonshme, për të

gjithë të pranishmit

. Në thelb, fjalët e mentorit tim ishin dritë udhëzuese në këtë rrugëtim liderishi. Ata jo vetëm që më dhanë njohuri, por edhe më frymëzuan për ta përvetësuar këtë rol me pasion dhe dëshirë në arritjen e qëllimeve. Sqarimi se çfarë do të thotë liderishi hodhi një themel të fortë dhe ishte thelbësor për krijimin e një pikënisjeje.

Kuptova se liderishi nuk duhet të jetë vetëm një qëllim i largët, por një sërë hapash që duhet të ndërmar, i cili u motivua nga inkurajimi i mentorit për të vazhduar me idetë që ndihmojnë në arritjen e vizionit. Kjo ishte thelbësore për të më lejuar të vendosja synime kuptimplote. Këshillat e mentorit në liderishi më ndihmuan të reflektoj mbi cilësitë dhe sjelljet e nevojshme për një udhëheqje efektive.

Ne si pjesëmarrës të këtij programi të pare na janë ofruar gjithashtu udhëzime për zhvillimin e organizatës, gjë që më kujtoi se liderishi përfshin

vizion afatgjatë.

Më motivoi të mendoj se si mund të kontribuoj në ndryshimin e qëndrueshëm brenda organizatës. Si lider, më inkurajoi që në mënyrë aktive të kërkoj dhe të fitoj aftësitë dhe njohuritë praktike të nevojshme për udhëheqje efektive.

Unë e kuptoj rëndësinë e vazhdueshmerisë së përparimit dhe të përpjekjes për sukses, i cili u perforcua nga ky standard i lart liderishi. Përmendja e partneriteteve nënvizoi rëndësinë e bashkëpunimit.

Më frymëzoi të kërkoja mundësi për punë ekipore dhe rrjetëzim për të çuar përpara qëllimet tona kolektive.

Ajo që e bëri këtë udhëtim vërtet të jashtëzakonshëm ishte grupi i larmishëm i liderëve në faza të ndryshme të zhvillimit të tyre. Të gjithë jemi bashkuar me një qëllim të përbashkët: të krijojmë diçka të re dhe të bëjmë një ndryshim. Ne ndamë përvoja, mësuam nga njëri-tjetri, e mbështetëm njëri-tjetrin dhe u rritëm së bashku si liderë.

Ne pjesëmarrësit e grupit të parë arritëm një moment të rëndësishëm në rrugëtimin tonë të lidershit. Ne të gjithë ndamë përvojat dhe rritjen tonë personale, duke marrë certifikatat e merituar si një dëshmi e përkushtimit dhe angazhimit tonë.

Grupit të dytë të liderëve që nisnin këtë udhëtim të jashtëzakonshëm me Shpresën, ju ofroj këtë këshillë: përqafoni çdo moment të të mësuarit, vlerësoni lidhjet që do të krijoni dhe besoni në fuqinë e ëndrrave tuaja.

Ky program do t'ju pajisë me aftësitë, njohuritë dhe do t'ju motivojë për të krijuar ndikim pozitiv në fushat tuaja përkatëse. Suksese drejt arritjeve tuaja në lider të suksesshëm.

Së fundi, dua të shpreh mirënjohjen time të përzemërt për Shpresën dhe të gjithë të përfshirët në këtë program në veçanti Organizatoren e seanceve Lediana Pajaj, e cila me durimin dhe profesionizmin e saj bëri që çdo seance të mbyllej me sukses. Mbështetja juaj e palëkundur, udhëzimi dhe besimi në potencialin tonë e bënë të mundur këtë udhëtim.

Nuk është thjesht një çertifikatë në liderishi që mbaj në duart e mia, por një ndjenjë e re e qëllimit dhe një angazhim frymëzues për një botë më të mirë. Faleminderit që na dhatë mundësinë për të qenë pjesë e diçkaje kaq domethënëse.

Mbasditja e festës së lidershit përfundoi me një bashkëbisedim ku të gjithë ne të pranishmit patëm mundësinë të lidhemi dhe të shkëmbejmë ide me individë me të cilët ndamë një pasion për liderishi dhe ndryshimin shoqëror. Ky eveniment ishte një dëshmi e fuqisë së bashkëpunimit, mentorimit dhe përkushtimit për të krijuar ndikim pozitiv në shoqëri në tërësi.

LINDA KELMENDI

# PERKUJTOHET NËNË TEREZA

Më 9 shtator, ekipi i "Shpresa Programme" organizoi një aktivitet të veçantë për të nderuar jetën dhe kontributin e jashtëzakonshëm të Nënë Terezës. Nënë Tereza, e njohur edhe si Shën Tereza e Kalkutës, ishte një murgeshë dhe misionare katolike, e lindur në Shkup nga prindër shqiptarë. Ajo ia kushtoi jetën e saj kujdesit për njerëzit e varfër dhe të marginalizuar në Indi dhe vende të tjera të botës.

Ky takim shërbeu për të përkujtuar trashëgiminë e Nënë Terezës, pikërisht vlerat e solidaritetit, bujarisë dhe mbështetjes për më pak të privilegjuarit. Këto janë po ashtu dhe parimet që "Shpresa" dhe partnerët e saj mbështesin përmes punës së tyre me komunitetin e migrantëve dhe refugjatëve në Mbretërinë e Bashkuar. Aktiviteti u mbajt në Kishën St. Katharine Cree në praninë e një grupi divers folësish dhe pjesëmarrësish, për sa i përket kombësisë, angazhimit profesional dhe prejardhjes sociale.

Në mesin e të pranishmëve ishin individë në poste zyrtare, ndër të cilët Ilir Kapiti, ambasador i Republikës së Kosovës në Mbretërinë e Bashkuar dhe Unmesh Desai, anëtar i Asamblesë së Londrës. Z. Kapiti ofroi në fjalën e tij një pasqyrë gjithëpërfshirëse të jetës së Nënë Terezës, duke theksuar se si filozofia dhe veprimet e saj i kapërcejnë kufijtë fetarë, gjeografikë dhe kohorë.

Në fjalën e tij, ai vuri në pah mësimet nga jeta e saj që janë të zbatueshme në të tashmen. "Trashëgimia e Nënë Terezës vazhdon të frymëzojë miliona individë edhe sot e kësaj dite. Thjeshtësia e saj, përlësia dhe angazhimi i saj i palëkundur për përmirësimin e njerëzimit shërbejnë si një shembull i ndritshëm për të gjithë ne" – tha ai. Nga ana tjetër, z. Desai u përqendrua në aplikimet praktike të këtyre vlerave dhe parimeve, duke ilustruar se si ato manifestohen në bashkëpunimin mes Kuvendit dhe organizatave si "Shpresa".

Nga ana tjetër, kontributet e Nënë Terezës rezonuan thellë me një grup liderësh të komunitetit shqiptar, duke përfshirë autorin 'bestseller' Tomor Kokona, Drejtoreshën e Departamentit të Riintegritimit të Refugjatëve, Adelina Badivuku dhe udhëheqësen e komunitetit, Remzije Duli.

Këta tre individë folën mbi përvojat e tyre si refugjatë gjatë viteve të trazuar 1990, të shënuara nga rënia e regjimit komunist në Shqipëri dhe nga përshkallëzimi i luftës në Kosovë. Ata reflektuan se si përballja me fatkeqësitë gjatë asaj kohe frymëzoi përkushtimin e tyre për të lehtësuar vuajtjet e të tjerëve.

Ata u frymëzuan nga angazhimi i palëkundur i Nënë Terezës për të ndihmuar njerëzit më pak me fat, pavarësisht rrethanave sfiduese. Ata treguan se si i zgjeruan përpjekjet e tyre humanitare duke ndjekur shembullin e saj.

Më tej, është e rëndësishme të thek-



sohet se aktiviteti nuk u kufizua vetëm brenda komunitetit shqiptar. Përkushtimi i përjetshëm i Nënë Terezës ndaj punës humanitare globale ka fituar admirimin e saj në mbarë botën dhe mësimet e saj rezonojnë përtej kufijve.

Rrjedhimisht, ngjarja mirëpriti individë nga kombësi dhe komunitete të ndryshme. Midis këtyre të pranishmëve ishin organizatat partnere të të "Shpresa", duke përfshirë këshilltaren Larisa Zilickaja dhe [Shtu një partner tjetër emrin], të cilët të gjithë janë të përkushtuar për të ndihmuar riintegrimin e komuniteteve të migrantëve dhe refugjatëve në MB.

Eventi pati një sërë shfaqjesh artistike dhe kulturore. Duke i qëndruar besnik elementit të diversitetit, pati poezi nga Aksa Canolli (nga Shqipëria), valle tradicionale të interpretuara nga Grupi i Valleve Bolivian dhe ansambli i Valleve të Ukrainës "Stefania", këngë ukrainase të prezantuara nga Tatiana Klyuiko, dhe, në fund, vallet dhe gatime tradicionale, përgatitur nga komuniteti shqiptar.

Në mbyllje, ngjarja e mbajtur më 9 shtator nuk ishte thjesht një homazh për një grua të shquar, por një festë e vlerave të qëndrueshme që vazhdojnë të formësojnë jetët dhe komunitetet në mbarë botën.

Trashëgimia e dhembshurisë, vetëmohimit dhe përkushtimit të palëkundur të Nënë Terezës mbetet një frymëzim për miliona njerëz. Të mbledhur në kishën St. Katharine Cree, të pranishmit dëshmuuan fuqinë e unitetit në diversitet.

# Akoma nuk keni një website?

*The Albanian*

## Akoma nuk jeni regjistruar në Google?

Për çdo konsultim mund te vini në çdo kohë në zyrat tona

Adresa e zyrave: 30 Avenons Road London E13 8HT

 **020 7018 7929**

 **073 4066 5946**

# byzantine

PRODUCTS

Byzantine Products Ltd  
Meadow Lea Nursery  
Dobbs Weir Road  
CM19 5JX



Contact : 07366688832 Email: sales.byzantine@gmail.com

# AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?

Akoma nuk jeni  
regjistruar në  
Google?!

**Për çdo  
konsultim  
mund te vini  
në zyrat tona**

*The* **Albanian**

**Adresa e zyrave:  
30 Avenons Road  
London E13 8HT**

**Na kontaktoni:**

**020 7018 7929  
073 4066 5946  
078 5997 7545**



**NE MUND T'U  
NDIHMOMJME EDHE ME:**

- Business Cards
- Logos
- Invoices
- Posters
- Quotations
- Banners
- Flyers
- Video Marketing
- Online Marketing
- Etc

# SULMUESIT NË VERI TË KOSOVËS, “TË STRUKTURUAR DHE TË PËRGATITUR”

Grupi i personave të armatosur që sulmoi pjesëtarët e Policisë së Kosovës në fshatin Banjskë të komunës së Zveçanit, nuk është strukturë spon-tane, por e organizuar dhe e parapërgatitur mirë, thonë njohësit e çështjeve të sigurisë.

Avni Islami, profesor i shkencave të sigurisë në Prishtinë, vlerëson se “formacioni imiton grupin mercenar rus, Wagner”, ndërsa Mentor Vrajolli nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë thotë se ai nuk ka mundur të veprojë “pa dijen e autoriteteve të Serbisë”.

Një pjesëtar i Policisë së Kosovës u vra dhe disa u plagosën të dielën në përleshjet me një grup të armatosur në pjesën veriore të vendit, të banuar me shumicë serbe.

Autoritetet thanë se rreshteri i policisë, Afrim Bunjaku, vdiq nga plagët e marra gjatë sulmit. Sipas tyre, sulmuesit e armatosur, rreth 30 syresh, ishin vendosur në manastirin e Banjskës, nga ku shkëmbyen të shtëna me organet e rendit gjatë gjithë ditës së diel.

Ministri i Brendshëm i Kosovës, Xhelal Sveçla, tha se tre sulmues u vranë, ndërsa gjashtë persona të tjerë, që dyshohet se ishin të lidhur me ta, u arrestuan.

Sipas Sveçlës, autoritetet konfiskuan edhe një sasi të madhe armatimi. Autoritetet e Kosovës bënë përgjegjëse Serbinë për sulmin, ndërsa Beogradi zyrtar serbët e Kosovës.

Çfarë thonë ekspertët e sigurisë?

Profesori Islami tha për Radion Evropa e Lirë se grupi i armatosur, i cili sulmoi policinë në Banjskë, ishte një formacion i strukturuar dhe i për-



gatitur mirë.

Sipas tij, grupi nuk funksionoi si i izoluar dhe i vetorganizuar, por si një formacion me uniforma, me armatim specifik dhe i lidhur “me institucionet e sigurisë së Serbisë”.

“Uniformat e tilla i ngjajnë grupit [mercenar rus] Wagner. Duket se ky grup i strukturuar edhe ishte imitues i grupit Wagner”, thotë Islami duke iu referuar mercenarëve rusë që kanë marrë pjesë në luftën në Ukrainë dhe në zona të tjera konfliktive.

“Armët e gjata, armët luftarake, të gjitha ato janë armë që përdoren në vijën e parë të frontit nga afërsia. Këto janë të mjaftueshme që të thuhet se ky grup terrorist, i lidhur me shtetin serb, ka kryer terrorizëm shtetëror në një territor të huaj”, thotë Islami.

Vrajolli, nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, thotë se, bazuar

nga mënyra se si u realizua sulmi në Banjskë, nuk mund të thuhet se formacioni kreu një akt spontan.

Sipas tij, ai veprimi i orkestruar dhe me plan për ta destabilizuar pjesën veriore të Kosovës. Një gjë e tillë, thotë ai, nuk ka mundur të ndodhë pa dijen e autoriteteve të Serbisë.

“Nëse flasim për mënyrën se si ata janë paraqitur, ajo tregon qartë se ata persona janë tra-

jnuar, janë përgatitur, kanë marrë resurse mjaft të kushtueshme që të mund të operojnë. Mendoj se është e pamundshme që [autoritetet serbe] të mos i kenë informacionet. Tash, lind pyetja: A ka qenë drejtpërdrejt shteti serb i përfshirë në këtë strukturë apo kanë qenë elemente radikale të përziera?

Kjo është vështirë të konfirmohet. Por, pasi që ka persona të arrestuar, atëherë informacionet se kush i ka shtyrë ata që të organizohen, do të gjenden”, shpreh bindjen Vrajolli.

Çfarë u tha në Prishtinë?

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se procesi i hetimeve do të ofrojë më shumë të dhëna se kush ishin personat e “formacionit profesionist” që sulmoi policinë, si hynë dhe kur hynë në Kosovë, si dhe kush janë urdhërd-

hënësit dhe dirigjuesit e sulmit

“Bëhet fjalë për një formacion terrorist e kriminal, profesionist, i cili e ka planifikuar dhe përgatitur gjatë këtyre çfarë ka kryer sot dhe që nuk paraqet një bandë të kontrabandës, por një strukturë mercenare, e cila është e përkrahur politikisht, financiarisht e logjistikisht nga Beogradi zyrtar”, tha Kurti.

Ministri i Punëve të Brendshme të Kosovës, Xhelal Sveçla, tha se bëhet fjalë për “grup terrorist”. Sipas tij, disa nga sulmuesit janë “pjesëtarë të Mbrojtjes Civile” – organizatë të cilën Qeveria e Kosovës e shpalli terroriste, në fund të qershorit.

Duke folur për Radio Televizionin e Kosovës, Sveçla tha se sulmi kundër Policisë së Kosovës është realizuar me mbështetjen e “shtetit të Serbisë” dhe drejtoi gishtin drejtpërdrejt kah presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq.

Çfarë u tha në Beograd?

Vuçiq i hodhi poshtë pretendimet e autoriteteve të Kosovës. Duke folur në një adresim të drejtpërdrejtë televiziv, ai tha se serbët të Kosovës u rebeluan “duke mos dashur që ta durojnë më tej terrorin e Kurtit”. Dy nga tre personat e vrarë nga grupi i sulmuesve, tha Vuçiq, janë nga Mitrovica e Veriut.

“Ne ende po kontrollojmë për t’u sig-

uruar që nuk janë emra të rremë”, tha ai.

“Fajtori i vetëm për atë që ndodhi në Kosovë është Albin Kurti”, tha Vuçiq dhe shtoi se sulmuesit nuk kishin uniforma të ushtrisë apo policisë serbe. Çfarë tha komuniteti ndërkombëtar? Misioni i NATO-s në Kosovë, KFOR, e dënoi vrasjen e policit Afrim Bunjaku dhe tha se është i gatshëm të ndërhyjë nëse është e nevojshme.

Ambasadori amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, tha se i dënon ashpër sulmet “e dhunshme dhe të orkestruara” ndaj Policisë së Kosovës.

Shefi i politikës së jashtme të BE-së, Josep Borrell, i cili ndërmjetëson edhe bisedimet midis Kosovës dhe Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve, tha se ka biseduar të dielën me udhëheqësit e të dyja vendeve. Borrell, u tha në një komunikatë të zyrës së tij, bëri thirrje për rivendosjen e qetësisë dhe stabilitetit.

Tensionet në veri

Pjesa veriore e Kosovës, përkatësisht komunat Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq, janë të banuara me shumicë serbe.

Popullata atje, e ndikuar nga Beogradi zyrtar dhe strukturat që funksionojnë nën udhëheqjen e tij, nuk u bindet vendimeve të institucioneve të Kosovës.

Ish-Ministri i Mjedisit Lefter Koka u dënua me 6.8 vite burg nën akuzat për korrupsion e pastrim parash në një gjykim ky 12 nga të pesëmbëdhjetë të akuzuarit u shpallën fajtor dhe u dënuan në total me mbi 40 vjet burg. Shumica dolën të lirë pasi vendimet e dënimit u pezulluan. Gjykata hoqi sekuestron preventive mbi shumicën e pronave të Kokës si dhe të një apartamenti të Bllakos.

Dymbëdhjetë nga pesëmbëdhjetë të akuzuarit për skemën korruptive të koncesionit të inceneratorit dhe fushës së plehrave të Fierit u shpallën fajtorë të hënën nga Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, në një nga tre procedimet penale të lidhura me të ashtuquajturën “afërë e inceneratorëve”. Pas shpalljes së vendimit nga gjykata, shumica e të akuzuarve të shpallur fajtorë lanë qelitë pasi gjykata konvertoi dënimet e tyre me shërbim prove ndërsa në burg duket se mbetën vetëm Koka, ish-deputeti Alqi Bllako dhe Loran Duzha, ish-administrator i koncesionit të Fierit.

Ish-Ministri i Mjedisit Lefter Koka, i cili gjendet në paraburgim që nga dhjetori i vitit 2021, u dënua me 6 vite e tetë muaj burg. Ai përfitoi nga gjykimi i shkurtuar ndërsa është deklaruar i pafajshëm ndaj akuzave.

## BURG KOKËS DHE BLLAKOS, BIRN: TRE INCENERATORËT I KANË KUSHTUAR TAKSAPAGUESVE DERI TANI 150 MILIONË EURO



Nëse vendimi do të mbetet në fuqi, Koka pritet të përfitojë edhe nga llogaritja me 1.5 ditë e periudhës së paraburgimit nga dhjetori i vitit 2021 dhe për rrjedhojë, mund të dalë nga burgju pas rreth katër vitesh. Ai është zyrtari më i lartë politik i dënuar pas ish-kryeministrit Fatos Nano, i cili u dënua më 1993 në atë që gjerësisht shihet si gjyq politik. Koka po gjykohej veçmas për incineratorin e El-

basanit. Biznesmeni Klodian Zoto, i cili gjendet në arrati që kur u shpall në kërkim në dhjetor të vitit 2021, mori dënimin më të lartë me 8 vite burg. Zoto u shpall fajtor për korrupsion aktiv dhe u dënua me dy vite burg, për mashtrim me pasoja të rënda dhe u dënua me 7 vite burg si dhe për krijimin e skemave mashtruese për TVSH dhe u dënua me gjashtë vite burg. Ai u

dënua gjithashtu me tetë vite burg për pastrim parash.

Ish-deputeti Alqi Bllako u dënua për shpërdorim detyre me 2.8 vite burg në rastin e inceneratorit të Fierit. Ai qe akuzuar për korrupsion nga SPAK, e cila pretendoi se ka përfutur 15 milionë lekë nga kompania e inceneratorit të Fierit. Por në dispozitivin e vendimit të gjykatës, Bllako u dënua vetëm për shpërdorim detyre.

Disa zyrtarë, të cilët ishin pjesë e grupit të punës që miratoi kontratën e koncesionit, u dënuan me nga dy vjet burg për abuzim me detyrën. Po kështu edhe biznesmenët që besohet se shërbyen si hallka për transferimin e parave. Të gjithë u dënuan me vendim të pezulluar, duke lënë në burg. Inceneratori i Fierit ishte kontrata e dytë koncesionare që qeveria e kryeministrit Edi Rama i dha një grupi biznesmenësh të ndërlidhur, nën supozimin se vendi kishte nevojë për impiante të eliminimit të mbetjeve me djegie.

Në vitin 2020, Partia Demokratike në opozitë kreu një kallëzim penal që çoi në hapjen e hetimit për incineratorin e Elbasanit ndërsa në vitin 2021, Lëvizja Socialiste për Integritet, forca politike në emër të së cilës Koka pati shërbyer si Ministër i Mjedisit, e akuzoi atë publikisht për korrupsion duke zbuluar një skemë të transferimit të parave nga kompanitë e inceneratorëve për të kompani apo persona të lidhur me të. LSI bëri denoncim në prokurori ndërkohë që Koka garoi në zgjedhjet e vitit 2021 për Partinë Socialiste duke fituar një numër të lartë votash. Koka dha dorëheqjen pak pas zgjedhjes si deputet dhe u arrestua disa muaj më vonë. Vendimi për Elbasanin pritet të jepet me 5 tetor.

SPAK po heton veçmas incineratorin e Fierit në bazë të kallëzimit nga Partia Demokratike. Një hetim i tretë është në vijim, për skemën e inceneratorit të Tiranës. Të trija skemat i kanë kushtuar taksapaguesve deri tani së paku 150 milionë euro./BIRN

SANDËR LLESHAJ

# KOSOVA NUK ËSHTË KRIMEA

Njësia ushtarake që sulmoi sot befasisht Policinë e Kosovës më solli ndërmend pamjet e vitit 2014, kur Rusia sulmoi Krimenë me një ushtri anonime, pa simbole dhe shenja identifikuese, duke përdorur shpërfillur krejtësisht ligjet e luftës.

Të ashtuquajturit “little green men” u shfaqën si fantazma, duke sulmuar aeroportet, bazat ushtarake dhe institucionet e Krimesë, ndërkohë që Putini dhe Rusia e tij ngrinin djallëzisht supet si krejt të pafajshëm për atë që po ndodhte përpara syve të të gjithë botës, e cila, si përherë, shihte duarkryq dhe plot hutim.

Edhe sot, në Kosovë, sulmoi një njësi e mirëfilltë ushtarake, me organizim, armatim, uniformë dhe të gjithë parametrat e nevojshëm që përbëjnë një formacion tipik ushtarak. E vetmja gjë që i mungonte kësaj njësie ishin simbolet mbi uniformë. Është pikërisht ky detaj që i bën ata shumë të ngjashëm me ato fantazmat e gjelbra të Krimesë, të cilët pak më vonë nga Rusia u quajtën “polite, armed men” si me thënë “burra të armatosur e të fisëm”, që në fakt ishin pjesëtarë të forcave speciale ruse, të ashtuquajturat “Spetsnaz”.

Me këto njësi ushtarake të anonimizuara prej mungesës së simboleve mbi uniformë, filloi Lufta e Ukrainës, ose tragjedia më e madhe në Europë pas Luftës së Dytë Botërore. Mungesa



e një reagimi të vendosur të Ukrainës dhe të botës demokratike asokohe solli më vonë atë që po shohim tash përtej dy vitesh në Ukrainë, fundin e së cilës askush nuk e ka të qartë ende.

Ajo që po ndodh sot në Kosovë, ka një ngjashmëri shqetësuese me Krimenë e 2014-ës. Besoj se leximit të deritanishëm të situatës në Kosovë nga vëzhguesit apo përgjegjësit politikë, kombëtarë e ndërkombëtarë, i mungon thellësia e plotë.

Në Kosovë nuk ka sulmuar thjesht një

grup i organizuar kriminal apo një bandë e armatosur!!! As thjesht një grup terrorist!!! Në Kosovë po zhvillohet një sulm ushtarak, që deri tani është përqendruar kundër Policisë së saj në kufi.

Asnjë pikëpyetje nuk mund të ketë për karakterin ushtarak të sulmit, ndërkohë për t'u sqaruar mbeten disa pyetje të tjera si për shembull:

– Nën komandën e cilit shtet është njësia ushtarake që ka sulmuar në veri të Kosovës?

– Cilat janë elementet e tjerë të strukturave ushtarake të përfshira në sulm, pasi është e vështirë të mendohet që kjo aventurë e rrezikshme të jetë e izoluar dhe jetime?

– Cilët janë objektivat e sulmit?

Sulme të tilla, mirëfilli ushtarake, por anonime në dukje, zhvillohen kështu për të shmangur përgjegjësinë ndërkombëtare të organizatorëve, të cilët e nxjerrin kokën pas suksesit, si Putini në Krimë në 2014, ose mbeten në hije në rast dështimi.

Sigurisht që sulmi në Kosovë do të thuhet dhe ndoshta shefat e tij do të mbeten zyrtarisht të panjohur, ndonëse nuk ka njeri me minimumin e arsyes që nuk i njeh ndërkohë ata.

Megjithatë, aktualisht mbetet me rëndësi jetike mposhtja me vendosmëri dhe me shpejtësi të madhe e sulmit në nivelin ushtarak. Këtë detyrë e kanë në radhë të parë forcat e sigurisë së Kosovës dhe KFOR.

Por sulmi duhet mposhtur edhe në nivelin politik. Për këtë ka përgjegjësi qeveria e Kosovës, qeveria e Shqipërisë, NATO, BE, OKB dhe të

gjithë ato forca që realisht janë të rreshtuara në mbrojtje të lirisë.

Është me rëndësi që reagimi politik kundër këtij precedenti të rrezikshëm të jetë i qartë dhe i vendosur. Reagimet anemike, ambigue si dhe dërdëllisjet letargjike apo deklaratat e lodhura burokratike, jo vetëm që nuk ndihmojnë, por përkundrazi inkurajojnë agresorët e maskuar në Kosovë.

Këtu nuk ka “palë”, por një agresor dhe Kosova nga ana tjetër.

Reagimi i shpejtë dhe i qartë tani është vendimtar që agresioni të ndalohet dhe organizatorët e tij të shkurohen dhe të vijnë që të mbeten edhe më tej “zyrtarisht” anonimë. Në të kundërt, ata do të mund të inkurajohen nga “suksesi”, të nxjerrin kokën dhe të vijnë mjeshtërinë e vjetër: përhapjen e zjarrit në Ballkan.

Pikërisht për faktin se rasti i Kosovës është shumë më i ndryshëm nga ai i Krimesë, edhe pasojat e përshkallëzimit të konfliktit do të ishin katastrofike. Por, ndryshe nga ukrainasit e 2014-ës, që e kishin bërë luftën e fundit në 1945-ën, shqiptarët e Kosovës e kanë mbyllur luftën e tyre vetëm para disa vitesh. Dhe me fitore!

## TË NDËRTOSH SHTET PRANË TË ETURVE PËR GJAK NJERIU!

KIM MEHMETI

Jo sot kur u vra edhe një polic i saj, po prej moti, Kosova tregon sa e rëndë është të ndërtosh ‘shtëpi’ pranë fqinjëve të etur për gjak njeriu.

Si dhe në kohë kur i ligu – Serbia – miklohet dhe shpërblehet, për ta joshur të shmangë udhën e krimit dhe kur i urti dhe viktima – Kosova – dënohet pse nuk janë më të kundërshtues ndaj vrasësve të tyre.

Po Kosova vështirë e ka të konsolidohet si shtet sepse ajo duhet të bashkëbisedoj për të ardhmen e vet me vrasësit e deridjeshëm të saj, të cilët nuk ndjehen keq pse i kanë duart e përgjakura, por pse nuk ia dolën të na shfarosnin.

Kosova nuk e ka të lehtë të konsolidohet si shtet sepse edhe shumë nga ata që e ndihmojnë atë të pajtohet me armikun e saj, janë të racës së keqe njerëzore që shëmtinë e vetë e mbulojnë me flamujt e rrejshëm të mirësisë njerëzore.

Por sido qoftë, sot kur toka e Kosovës u ujit edhe me gjakun e policit Afrim Bunjaku ajo më bindshëm se kurdo qoftë dëshmoi se gjitha orvatjet për ta zhbërë, atë vetëm e kanë forcuar dhe e kanë bërë më të qëndrueshme në betejën për të dëshmuar se shqipëtarët e saj e dinë se shtetin dhe lirinë i meritojnë vetëm për atë që sa je i gatshin ato t'i mirëmbash dhe t'i mbrosh.

Dhe sot, kur Beogradi tregon hapur se



ka mbet atë që ishte – kryeqendra e luftërave të reja ndëretnike – duhet

kuptuar se sado paqësorë qofshim, ne s'kemi si e pengojmë atë në synimet

e tij luftarake.

Andaj ne nuk duhet të merremi me atë se çka thonë për ne ‘Borrelot’ e ‘Lajçakët’ por të bëjmë atë që i jep kuptim jetës më shumë se çka do qoftë tjetër: pasardhësve tanë të mos ua lëmë trashëgimi turpin, por betejën e fituar ndaj një Serbie që dinë të nxitë luftë, por jo edhe të ndërtojë paqe si dhe ndaj burrështetasve të sotëm serb të cilët e kanë të vulosur në ballë urrejtjen ndaj nesh.

Pra ne sot si kurrë më parë duhet të jemi paqësorë që a kanë kuptuar se jo rrallë herë, kur e ke për fat të kesh ‘shtëpi’ pranë atyre që i lumturon fatkeqësia jote, lirinë dhe rehatinë vetjake duhet t'i ‘paguash’ me më të shtrenjtën që ke - me gjakun tënd!

KLODIAN TOMORRI

Hezitimi i SPAK për të hapur qoftë dhe një procedurë të thjeshtë verifikimi për çështjen McGonigal dëshmon se nuk mjaftojnë as gjysmë miliardë euro për të patur një sistem drejtësie që nuk ka frikë nga kryeministri.

Ajo që nuk bëhet me shumë para, bëhet me më shumë para, siç thotë një proverb matanë Atlantikut. Por druaj se ne këtej, ndoshta nuk do ta marrim vesh asnjëherë se sa para të tjera duhen akoma që Arben Kraja, Altin Dumani apo të tjerët që do të vijnë më pas të mos kenë frikë nga Edi Rama. Në fund të fundit, SPAKU dhe e gjithë reforma në drejtësi janë produkte "Made in Albania." Me pak fjalë, një gjellë cirku. Dhe meqë ra fjala tek cirku, protagonistin kryesor dhe aktori më djallëzor i tij është padyshim kryeministri. Ky nuk e ka për gjë të sajojë intriga ruse dhe goditje poshtë brezit për të vrarë opozitën. Madje kur puseta e madhe shpërthen dhe era e saj ndihet deri matanë oqeanit, kryeministri ka aftësinë që t'a bindë popullin se kjo nuk është aromë pusete, por parfum. E vërtetë. Qeveritë kanë detyrimin të denoncojnë çdo krim. Por këtë e bëjnë përmes kanaleve zyrtare dhe rrugëve ligjore. Jo duke u paguar udhëtimet dëshmitarëve të sajuar apo duke futur

në kllapë agjentët sekretë të shërbimeve partnere. Megjithatë, se sa seriozisht e kishte qeveria për të zbardhur krimin rus të Lulit, e panë të gjithë kur nisën hetimet në Tiranë. Pra ky ishte atentat i pastër për të vrarë opozitën, e cila më pas u mor peng. Richard Nixon, ish presidenti i SHBA-ve bëri shumë më pak se kaq në skandalin e ëatergate. Ai opozitën thjesht e përgjoi, nuk tentoi ta vraste as ta merrte peng.

Megjithatë, kjo strategjia e parfumit mund të funksionojë shumë mirë në Shqipëri, por andej matanë nuk pi dot ujë. Me gjithë përpjekjet e mëdha disa mujore, këtë herë kryeministrin nuk na e begenis askush në Uashington. Përveç Juri Kimit, sigurisht. Kur bëhesh toksik nuk bëjnë më pune as paratë. Por shqyr që qelloi ai rusi në OKB.

Protagonisti i dytë i cirkut tonë të madh është Lulzim Basha. Madje, ky është i vetmi fiks në rolin e vet. Atë të

# PRAPËSIRA MCGONIGAL DHE CIRKU YNË I MADH



humoristit të estradës që nuk bën më askënd të qeshë pavarësisht se përiqet me gjithçka.

Zoti Basha thotë se afera McGonigal ishte një komplot i madh ndaj tij, i sajuar nga politika e vjetër e Trekëndëshit të Bermudës dhe se e vërteta vonon, por ajo nuk mund të fshihet. Luli i politikës së re mendon se McGonigal u pajtua për të vrarë atë, jo opozitën.

Askush me dy fije mend në kokë nuk e beson që Basha mori 500 mijë dollarë nga Putini, të cilat më pas i çoi në SHBA. Por të gjithë e kanë të qartë se 500 mijë dollarët zor se kanë ndonjë burim të ligjshëm. Ah po. U mblodhën nga diaspora në SHBA.

Pra në vend që t'u kerkojë një falje të madhe demokratëve se u vuri damkën e financimeve ruse, vetëm e vetëm që të kapte një foto me Donald Trump, zoti Basha thotë se ai është viktima e vërtetë e komplotit të madh McGoni-

Nëse zoti Basha do të ishte kryetar i vulës pa anëtarë siç është sot, as kryeministri diabolik dhe madje as Taulant Balla, nuk do ta merrnin mundimin të shpenzonin qoftë edhe nje cent për të e jo me t'i benin atentat me agjentë sekretë në SHBA. Por të ndalem pak tek sallata ruse.

gal. Kjo është arsyeja se pse me estradën e Lulit nuk qesh më askush.

Por cirku ka dhe një protagonist të tretë. Ky është kryetari i opozitës me anëtarë, por pa vule. Saliu thote se tani që McGonigal e pranoi fajin, në shkurt amerikanët do të arrestojnë Ramën, Duçkën dhe Nezajn. Madje sipas tij, gjykata amerikane do të denoje me 5 vjet burg McGonigalin, ndërsa Rama do të dënohet 7 vjet.

Mire ërë Doktor. Vetëm na thuaj, Ramën ku do e arrestojnë? Në Kryeministri apo do ta cojnë prapë tek ai ishulli i izoluar që na the se e cuan para disa muajsh. Në vend që të bëjë kallëzim në SPAK dhe t'ia lërë SPAK-ut topin në derë, Doktorit tregon përralla me arrestime dhe rrëmbime në ishuj të fshehtë.

Ja pra, ky është cirku ynë i madh, ku të gjithë janë në rol. Edi, Luli, Saliu dhe SPAKU.

La Rotonda offers a combination of hearty Italian food, a vast selection of fine wines and an exceptional service all in a relaxed atmosphere



## La Rotonda



229 Muswell Hill Broadway,  
Muswell Hill, London N10 1DE



BOOK NOW FOR AN UNFORGETTABLE TIME 020 8374 3949

# NJË DREKË NË JERUSALEM, NJË DREKË NË PARIS, 20 VJET NDËRMJET

VETON SURROI

Para afro 20 vjetësh isha në drekë në Jerusalem. Më ftoi një mik hebre, profesor universitar, shkrimtar dhe ish-diplomat. Me një përvojë të gjatë jetësore më përmendi një përgjigje që u jep njerëzve që vijnë nga BE-ja për të dhënë sugjerime se si duhet të zgjidhet konflikti izraelito-palestinez:

“Pse nuk e zgjidhni njëherë konfliktin Kosovë-Serbi e pastaj vini te ne?”.

Javën e kaluar dhe afro njëzet vjet më pas më ftoi në drekë një mik francez në Paris, profesor universitar dhe njëri prej njohësve më të mirë të Evropës ish-komuniste. I ramë gjerë e gjatë Evropës së sotme, përfshirë asaj pjese që ishte komuniste me luftën e Rusisë kundër Ukrainës, dhe miku im tha se po ty pyesnin për ardhmërinë evropiane ai do t’u sugjeronte ukrainasve që të shikojnë me vëmendje Ballkanin Perëndimor.

Ukrainës ka gjasa që këtë fundvit (së bashku me Moldavinë) t’i hapet procesi negociator për anëtarësim në BE. Para njëzet vjetësh Ballkanit Perëndimor iu premtua perspektiva evropiane. Një vend, Maqedonia Perëndimore, ka po aq stazh të qenit shtet kandidat për anëtarësim.

2.

Ukrainasit, të zënë në një luftë metër për metër në territorin e tyre, do ta kenë të vështirë komoditetin e të kuptuarit të Ballkanit Perëndimor. Dhe, nuk është se ka ndonjë mësim të mirë të mësohet nga këtë: BE-ja nuk ka ndonjë rezultat të mirë në qetësimin apo integrimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Më 14 shtator, BE-ja tregoi se sa e dobët mund të jetë në politikën e vet të jashtme. Një vit pasi Gjermania dhe Franca (më vonë u bashkëngjiti edhe Italia) prodhuan një plan njëfaqësh normalizimi të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë e me presion të peshës së madhe të investimit personal të Kryeministrit gjerman e Presidentit francez arritën të marrin pëlqimin e Kosovës dhe Serbisë, ndërmjetësimi i BE-së prodhoi një sërë tekstesh të negociuara e të stërnegociuara që u larguan nga plani origjinal sa i kthyen negociatat në vitin 2013. Atëbotë koncepti “historik” i BE-së që, që në këmbim të autonomisë territoriale të serbëve të Kosovës, Kosova dhe Serbia të fillonin një proces normalizimi që do të shpinte ndoshta te njohja de facto e dy shtetësive të veçanta.

Pas shumë vjet dështimesh dhe bredhje (përfshirë edhe bisedimesh Thaçi-Vuçiq për këmbim terrioresh), Gjermania dhe Franca dolën në shtator të vitit 2022 me planin, i cili vendoste në formë eksplicite



marrëdhëniet mes Kosovës dhe Serbisë si marrëdhënie shtetesh sovraane, të cilat brenda kësaj kornize juridike do të gjenin zgjidhje për problemet e ndërsjella, përfshirë edhe modalitete të tjera inovative për mbrojtjen dhe zhvillimin e identitetit dhe kushteve të jetës së serbëve të Kosovës.

Ndërmjetësimi i BE-së në 12 muajt e fundit e ktheu përmbys Planin frankogjerman dhe e shndërroi në një karikaturë të vitit 2013: krijoni autonominë e serbëve të Kosovës, pastaj flasim për të tjerat.

3. Është vështirë për ukrainasit sot të përqendrohen në hollësi, por nëse duan të kuptojnë politikën e BE-së karshi Ballkanit Perëndimor, atëherë hollësitë janë më të rëndësishme sesa titujt e mëdhenj të marrëveshjeve historike.

Në nëntor të vitit 2022, pas shumë vjet negociatash, dhe me ndikim vendimtar të Gjermanisë, gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor nënkshkruan brenda Procesit të Berlinit tri marrëveshje të mobilitetit. Njëra prej tyre, ajo e kalimit prej njërit shtet në

tjetrin me letërnjoftime, duhej të ishte simbol i normalitetit për një regjion që më 2020, në Samitin e Sofjes mes BE-së dhe Gjashtëshes së Ballkanit Perëndimor, ishte zotuar se do të krijonte një treg të përbashkët regional me vendosjen e katër lirive të BE-së në territorin e tyre.

Në nëntor të këtij viti, pra më 2023, ka të ngjarë që një vend, Bosnjë-Hercegovina të mos e ratifikojë këtë marrëveshje, meqë përfaqësuesit e entitetit (me fuqi bllokuese) të quajtur Republika Sërpska nuk lejojnë që kjo marrëveshje të ratifikohet, ngase prek “interesat vitale” të këtij entiteti.

Për më tepër, në maj të këtij viti, Republika e Serbisë, në procedurë të rregullt kushtetuese të miratimit të një marrëveshjeje ndërkombëtare, ratifikoi me ligj marrëveshjet e mobilitetit. Në tekstin e ratifikimit, Kuvendi i Serbisë bëri po ashtu një truk që i zhvlerëson këto si marrëveshje ndërkombëtare. Kuvendi i Serbisë përshkroi rezervën e vet në tekst, duke cekur se fakti që këtë ligj e ratifikon si marrëveshje ndërkombëtare nuk do të thotë se ka lidhur

marrëveshje ndërkombëtare me Kosovën sipas Konventës së Vjenës për traktate; Kosovën vazhdon ta trajtojë si “territori i Kosova e Metohisë si pjesë e Republikës së Serbisë”.

Në nëntor të vitit të kaluar, diplomatët evropianë shpresuan se u kalua një test i rëndësishëm i dyfishtë. Nga njëra anë bëhej e mundur lëvizja e lirë e qytetarëve të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor. Nga ana tjetër vendosej një precedent juridik, mbi të cilin mund të ndërtoheshin marrëveshjet e ardhshme, pra precedenti juridik i barazisë së palëve.

Një vit më pas, këto ende mbeten objektive për t’u arritur, e me këtë ritëm dreka e ardhshme pas njëzet vjetësh në ndonjë vend do të dëshmonte se BE-ja ende nuk ka mësuar gjë.

4.

Po nga doli Ukraina në këtë rrëfim? Për arsye të thjeshtë se për njëzet vjet, prej Samitit të Selanikut, BE-ja nuk ka pasur ndonjë përgjigje për konfliktet e papërfunduara të Ballkanit Perëndimor dhe vendet e këtij regjioni do të mbeteshin aty ku janë,

në një proces të përhershëm të menaxhimit të konfliktit, po të mos shpërthente lufta e Rusisë kundër Ukrainës. Me të shpërthyer kjo luftë, BE-së iu ringjall instinkti i detyrave historike dhe gjatë një viti e gjysmë u bashku në përkrahjen e Ukrainës.

Njëkohësisht, BE-ja këtij ndryshimi të madh epokal po i përgjigjet me një ndryshim po kaq të madh epokal: të trajtimit të Ukrainës si një shtet të ardhshëm anëtar të BE-së. Në këtë ringjallje instinkti historik, jo pak njerëzve duhet t’u ketë rënë në mend se nuk do të ishte e hijshme të fillonin negociatat e anëtarësimit me Ukrainën, por jo edhe me BH-në apo Maqedoninë e Veriut, për shembull.

Pra, njëzet vjet më pas, Ballkanit Perëndimor iu desh një luftë e largët që të ringjallëshin ambiciet e anëtarësimit në BE. Por vala ukrainase, në të cilën tash kanë hipur vendet e Ballkanit Perëndimor, mund të kalojë pa ndonjë rezultat për të mbajtur mend, nëse kuti matës i përparimit është politika e tanishme e jashtme e BE-së.

koha ditore

## ANDI BUSHATI

Pranimi i fajit përpara një gjykate në Uashington, nga ish-agjenti i FBI, Charles McGonigal, është si ajo historia e gotës që mund ta shohësh ose gjysmë bosh, ose gjysmë plot.

Të parët mund ta vënë theksin në pikën se marrëveshja e arritur mes prokurorëve dhe avokatëve, do të bëjë të pamundur qëmtimin e episodeve, detajeve dhe fakteve që do të ofronte një proces i rregullt. Për shkak të saj, ne ndoshta nuk do të marrim vesh asnjëherë, se kur u fol për herë të parë mes ish agentit dhe Ramës për një plan të përbashkët për shkatërrimin e opozitës, se cila ka qenë shifra e plotë që ai mori për të hetuar fabulën e fabrikuar në Tiranë, për financimin me para ruse, apo se cila ka qenë natyra e asaj “lidhjeje të papërshtatshme” me kryeministrin shqiptar, që konsumohej përmes bisedave në aplikacionin Viasat, ashtu siç rrëfeu Alison Guerrero, e dashura ilegale e McGonigal.

Por, pavarësisht se pranimi i fajësisë dhe mosvazhdimi i procesit mund të varrosë përgjithmonë një varg imtësisish, që do mbanin gjallë kërkimin e gazetarëve, luftën e opozitës dhe vuajtjet e publikut, ai ka dhe anën e vet, të gotës gjysmë plot. Mbetja e disa të dhënave në hije, nuk e zbeh aspak faktin se bashkë me McGonigal, në të njëjtin krim, ka qenë i përfshirë edhe kryeministri shqiptar.



Deklarata e pranimit të fajit para gjykatës, ku Edi Rama është një personazh kryesor, pranon, as më pak dhe as më shumë, atë që shkruante New York Times, në investigimin e tij, se “McGonigal ndërmori hapa në favor të Ramës” për të goditur opozitën. Kjo u konfirmua edhe këtë të premtë, nga pyetja që gjyqtarja Colleen Kollar-Kotelly i bëri në proces ish agentit të FBI. Ai pranoi para

saj se kishte vënë në lëvizje prokurorinë amerikane për çështjen e lobimit me para ruse të opozitës.

Por, për të kuptuar më mirë rëndësinë e këtij pohimi, pra se si u bë McGonigal, pjesë e një skenari politik për goditjen e kundërshtarëve të Edi Ramës, është e nevojshme ti rikthehemi pak kronologjisë së ngjarjeve,

## NË UASHINGTON MCGONIGAL E PRANOI FAJIN, NË TIRANË FAJI MBETI KOPIL

që Lapsi.al e ka investiguar me detaje.

Aty vërehen përkime të frikshme, në data, mes pagesave që merr ish agjenti dhe lëvizjeve që ai bëri kundër PD dhe Lulzim Bashës.

Në **gusht 2017**, McGonigal i kërkoi borxh shqiptaro amerikanit Agron Neza. Në **shtator** të dy udhëtojnë drejt Tiranës dhe priten nga Rama. Menjëherë pas kësaj, McGonigal, paguhet me të paktën 225 mijë USD.

Pas dhënies së dollarëve në **nentor** të tre takohen përsëri në Tiranë. Menjëherë fillon dhënia e dokumentave me burim nga kryeministria, kundër opozitës. Këto materiale që serviroshin nga Neza dhe këshilltari informal i kryeministrit, Dorian Duçka, i jepen FBI-së. Duçka paguan edhe shpenzimet për dëshmitarët që dëshmojnë për FBI-në lidhur me këtë ngjarje dhe kjo i mbahet e fshehtë këtij institucioni. Në **shkurt 2018**, hapet hetimi zyrtar kundër lobistit Nik Muzin që kishte marrë nga basha mbi 600 mijë dollarë.

Pra pyetja që shtrohet është e thjeshtë, pse dy biznesmenë, në punë të tyre, do paguanin nga xhepi i vet, për të luftuar opozitën? Pse qëllon “rastësisht” që njëri prej tyre është edhe

këshilltari i Ramës dhe furnizohet me dokumenta nga kryeministria? Pse pagesa 225 mijë USD kryehet pasi McGonigal takohet me kryeministrin dhe pse hetimi kundër opozitës nis menjëherë sapo ai ka marrë paratë?

Këto gjashtë muaj, mes shtatorit 2017 dhe shkurtit 2018, janë një dëshmi ulëritëse se regjimi shqiptar ka korrptuar zyrtarin më të lartë të FBI, të akuzuar ndonjëherë për tradhëti kaq të lartë.

Prandaj alibia e idhtarëve të gotës gjysmë bosh, që kërkojnë ende prova të tjera për tu bindur është e pa vlerë. Drejtësia e amerikane e bëri punën e saj. Ndonëse me një marrëveshje qv varrosi shumë detaje, ajo e detyroi McGonigalin, ta pranojë fajin se i mbajti të fshehtë institucionit ku punonte, marëdhënien okulte që krijoi në këtë vend.

Ndërsa drejtësia shqiptare, e dizenuar nga amerikanët, as denjon të merrret më këtë krim të kryer në sy të të gjithëve. Ajo preferon ta lërë fajin kopil, duke mbajtur në fuqi praktikën e një vendi të korrptuar, që ndonëse pretendonte ta bënte SPAK-un dhe BKH-në, si FBI, që i aftë të “shqiptarizonte” edhe agjentët më të spikatur të kësaj të fundit./ Nga Lapsi.al

Konflikti i armatosur në Kosovë sikur i ka zënë në befasi autoritetet në Beograd. Këto zhvillime kanë ngritur shumë pyetje që ende nuk kanë përgjigje.

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vučić theksoi se vendi (Serbia) është në gjendje të rëndë dhe thekson se ky është momenti më i vështirë për vendin dhe popullin serb, që nga viti 2004 dhe 2008.

Sipas tij, fajtori kryesor për situatën aktuale është Albin Kurti, i cili dëshiron ta fusë Serbinë në konflikt me NATO-n. Aleksandar Vučić i bëri thirrje bashkësisë ndërkombëtare që të formohet Asociacioni i Komunave me shumicë serbe dhe të ketë policë serbë në veri, sepse vetëm kështu mund t'i jepet fund konflikteve.

Kryengritja për shkak të “terrorit të Kurtit”

Kur bëhet fjalë për vetëkonfliktet e armatosura, të cilat pala shqiptare i vlerësoi si terrorizëm, presidenti i Serbisë theksoi se “serbët u rebeluan për shkak të terrorit të Kurtit dhe arrestimeve të shumta të serbëve nga Policia e Kosovës”. Aleksandar Vučić thotë se qëllimi kryesor i pushtetarëve në Prishtinë është që ta fajësojnë Beogradin për vrasjen e policit dhe se kjo mundësi është shfrytëzuar edhe për propagandë kundër Kishës Ortodokse Serbe. Ai theksoi se autoritetet serbe ende janë duke u shqyr-

## ANALIZA E DW: KUSH MBAN PËRGJEGJËSINË PËR KONFLIKTET NË VERI DHE CILAT DO TË JENË LËVIZJET E RADHËS SË KOSOVËS E SERBISË

tuar të gjitha detajet e ngjarjeve tragjike dhe se në bazë të kësaj do të përgatitet terreni për marrjen e vendimeve të mëvonshme.

Vendimet e shumta të gabuara

Për momentin realisht kemi shumë pyetje të hapura, thotë analisti i politikës së jashtme Boshko Jakshiq për DW.

“Para së gjithash, çfarë kërkonte grupi i armatosur i serbëve në manastirin e Banjskës dhe cili ishte qëllimi i tubimit atje”, shton ai. Në anën tjetër, sipas Jakshiq, nuk është shumë e qartë pse Policia e Kosovës akoma nuk e ka bërë të ditur identitetin e serbëve të arrestuar. Pra, ka një sërë paqartësish, por dimensionin politik është pakrahasueshëm më i rëndësishëm se të gjitha të tjerat, thekson bashkëbiseduesi ynë. “Së pari tregon se sa i gabuar ka qenë vendimi për largimin e serbëve nga institucionet e Kosovës dhe nga Policia e Kosovës. Është e vërtetë që Kurti po shkakton incidente, por duke qenë se Vučić i udhëheq këto negociata dhe se është ai që duhet të sigurojë sigurinë e serbëve, kjo është një lloj disfate për Vuçiqin”, pohon Jakshiq.

Beogradi ka humbur epërsinë

Ministri i Punëve të Jashtme Ivica Dačić deklaroi se “ata që e përkrahën agresionin ndaj Serbisë në vitin 1999 vazhdojnë politikën e tyre dhe mbështesin Albin Kurtin, dëshira e të cilit është të shkaktojë luftë”. Sipas tij, bashkësia ndërkombëtare praktikisht lejon që të ndodhë një konflikt në Kosovë. Sipas tij, “populli serb ka të drejtë të mbrohet dhe të shprehë vullnetin e tij politik dhe se nuk dëshiron konflikt me askënd”.

Ndërsa kryeministria Ana Brnabić akuzoi Albin Kurtin për përshkallëzim aktual dhe thotë se “presidenti serb Aleksandar Vučić edhe më parë ka paralajmëruar se mund të ketë konflikt të armatosur në veri të Kosovës”. Përshtypja në Beograd është se ky zhvillim i ngjarjeve nuk i ka pëlqyer palës serbe, sepse vjen në kohën kur dukej se Albin Kurti disi po e humbte mbështetjen e faktorëve ndërkombëtarë. Këtë përshtypje ndan edhe Boshko Jakshiq, i cili “nuk mendon se pas këtij veprimi qëndron Vuçiqi, por kjo e bën problemin edhe më serioz”. Kjo mund të nënkuptojë se presidenti Vuçiq nuk e ka, ose e ka humbur kontrollin mbi nacionalistët militantë. Nuk e dimë nëse është ky aksion është zhvilluar në bashkëpunim me

rusët, të cilët përmenden, por mund të themi me siguri se serbët e kanë humbur avantazhin që ua kishte dhënë Kurti javët e fundit. Promovimi i ndikimit rus është një nga komponentët e kësaj krize. Mendoj se pas vrasjes së policit nuk flitet më për asociacionin e komunave serbe”, tërheq vëmendjen Jakshiq. Presidenti i Serbisë tashmë ka pasur një takim me lidhur me këto ngjarje me ambasadorin rus në Beograd Aleksandar Bocan Harçenko, ku ishte edhe ministri i Punëve të Jashtme Ivica Dačić. Me atë rast, presidenti Vučić e njoftoi ambasadorin rus “për faktin se në Kosovë dhe Metohi po kryhet spastrim etnik brutal i organizuar nga institucionet e përkohshme të Prishtinës dhe nga Albin Kurti, me mbështetjen e një pjese të bashkësisë ndërkombëtare”, deklaroi Vuçiq në Instagram.

Kujt i shkon në favor status quoja? Presidenti i Serbisë po ashtu vlerësoi se ky ishte një lloj rebelimi nga ana e serbëve “për shkak të terrorit të Kurtit” që po bën së fundmi. Sipas bashkëbiseduesit tonë, “tingëllon logjike, por gjithmonë bëhet një gabim me këtë rast. Gjithmonë thuhet se është arrestuar një serb, por nuk

thuhet shkak pse është arrestuar dhe për çfarë dyshohet. Thjesht fakti që dikush është serb e shfajëson atë menjëherë nga çdo lloj faj dhe në këtë mënyrë po rritet tensioni”.

Është e vështirë të parashikohen lëvizjet e ardhshme të të dyja palëve. Tani për tani kemi dënime të fuqishme të sulmeve të grupeve të armatosura ndaj pjesëtarëve të policisë që po vijnë nga përfaqësues ndërkombëtarë. Boshko Jakshiq beson se “do të përdoret fraza e zakonshme që përsëritet në situata të tilla, që është de-përshkallëzimi. Me siguri do të vijë deri te kjo. Nuk është as në interesin e Kurtit që konflikti të përshkallëzojë, e aq më pak është në interesin e Beogradit. Kjo do të thotë rikthim në status quo, që është situata më e keqe, sepse mua më duket se një gjë e tillë i përshtatet më së shumti Kurtit dhe Vuçiqit, pavarësisht se ky status priset ndonjëherë nga disa incidente. Por të krijohet përshtypja se ajo që quhet bashkësia ndërkombëtare nuk ka metoda efektive për të ushtruar presion mbi të dy për të bërë një lloj përparimi”, përfundon Boshko Jakshiq.

DW

*Akoma nuk keni një website?*



**Akoma nuk jeni  
regjistruar në  
Google?**

*Porosit  
websitin tend*

**Për çdo konsultim mund të vini tek zyrat tona**

**Adresa e zyrave: 30 Avenons Road  
London E13 8HT**

**NA KONTAKTONI:**

**TEL: 020 7018 7929**

**MOB: 073 4066 5946**

**MOB: 078 5997 7545**





# Te gjitha e Ballkanit ne nji Market produktet

318-324 Kilburn High Road, London, NW6 2QN | Tel: 020 7372 1059



# Dëshironi një **Banner** për biznesin tuaj?



- **Business Cards**
- **-Logos**
- **-Invoices**
- **-Posters**
- **-Banners**
- **-Video Marketing**
- **-Online Marketing**

 **Adresa e zyrave: 30 Avenons Road London E13 8HT**

 **Tel: 020 7018 7929 Mob: 073 4066 5946**  
**Mob: 078 5997 7545**